

BULETINI I SHKENCAVE GJEOLOGJIKE



VITI (XXV) I BOTIMIT

4

1989

Tiranë

PËRMBAJTJA E LËNDËS (CONTENTS)

— Ngjarje e rëndësishme për gjelogjinë shqiptare	3
<i>(An important event for the geology of Albania).</i>	
— Fjala e hapjes mbajtur nga Prof. Eshref Pumo	5
<i>(The opening speech delivered by Prof. Eshref Pumo).</i>	
— Me perspektiva e rritje në të ardhmen	7
<i>(With a perspective of growth in the future).</i>	
— Kërkimet gjeologjike, nxjerrja dhe përpunimi i mineraleve të ngurta, i naftës dhe gazit. (Fjalat e mbajtur nga sh. Besnik Bekteshi, anëtar i Byrosë Politike të K.Q. të PPSH dhe ministër i Ministrisë së Industrisë, Minierave dhe Energjitikës	9
<i>(Geologic prospection, extraction and processing of the solid minerals, oil and gas. The speech delivered by the comrade Besnik Bekteshi, the member of the Political Bureau of the CC of the PL of Albania and Minister of Industry, Mining and Energetics).</i>	
Telegram shokut Ramiz Alia, Sekretar i Parë i K.Q. të PPSH	23
<i>(Telegram to Comrade Ramiz Alia, First Secretary of the Central Committee of PL of Albania).</i>	
— Fjala e mbylljes mbajtur nga Aleksandër Çina, Kryetar i Komisionit Shkencor të Konferencës	25
<i>(The closing speech delivered by the comrade Aleksandër Çina Chairman of the Scientific Commission of Conference).</i>	

REFERATE (REPORTS)

A. Çina, D. Mezini, A. Kodra — Arritje dhe perspektiva të zhvillimit të kërkimeve gjeologjike në vendin tonë	27
<i>(The achievements and perspectives of the development of geological prespections in our country).</i>	

KUMTESAT (PAPERS)

Grupi i autorëve të monografisë dhe të hartës Metalogjenike të Shqipërisë, në shkallën 1:200 000 — Disa tipare kryesore të metalogjenisë së Shqipërisë (Referuar nga M. Shallo)	39
<i>(Some main features of the metallogeny of Albania).</i>	
A. Kodra, K. Gjata — Evolucioni mesozoik i Albanideve të brendshme fazat e riftëzimit dhe zgjerimi oqeanik Mirditor	55

(Mesozoic evolution of the Inner Albanides, rifting stages and the Mirdita's oceanic spreading).

H. Hallaçi, S. Qorlaze, M. Ylli, Ll. Langora, V. Gjoni, K. Dhima, R. Ceni, S. Shabani, V. Tasini — Ligjësitë e përgëndrimit të mineralizimit kromitik në masivin ultrabazik të Bulqizës dhe veçoritë strukturore të vendburimeve

67

(The regularities of the concentration of chromitic mineralization in the ultrabasic massifs of the eastern belt).

Shq. Stërmasi, A. Çina, H. Hallaçi, B. Jahja, Q. Lena, S. Alia, F. Çollaku — Vendosja e mineralizimit kromitik në masivin ultrabazik të Bulqizës dhe veçoritë strukturore të vendburimeve

77

(The distribution of the chromitic mineralization in the Bulqiza ultrabasic massif. Structural features of ore deposits).

N. Mekshiqi, S. Hoxha, H. Osmani — Veçoritë petro-strukturore dhe ligjësitë e vendosjes së mineralizimit të kromit në masivin ultrabazik të Tropojës

91

(Petrological-structural features and the mode of the setting of chromium mineralization in the Tropoja ultrabasic massif).

B. Shehu, R. Selimi, A. Meshi — Tiparet gjeologo-strukturore të masivit ultrabazik të Kukësit dhe krommbajtja e tij

105

(Geological structural features of the Kukësi ultrabasic massif and its perspective).

A. Hamzallari, P. Kokona, Z. Zeqillari, S. Plaku, M. Borova — Ndërtimi gjeologo-strukturorë i masivit ultrabazik të Shebenik-Pogradec, mineralizimi kromitik në të dhe perspektiva e tij

115

(Geological-structural features of the Shebenik-Pogradec ultrabasic massif and its perspective for chromitic mineralization).

A. Çina — Mineralizime të elementëve të grupit të platinit në kompleksin ofiolitik të Albanideve

125

(Platinum group element mineralizations in ophiolite complex of Albanides).

A. Tashko, A. Marto, I. Alliu, A. Tërshana — Ndiqmesa e studimeve petrologjike në sqarimin e problemeve të gjenezës së vendburimeve të kromit dhe ndërtimit të brendshëm të masivëve ultrabazikë

141

(Contribution of the petrological investigations for the classification of the genesis of chromium deposits and the inner structure of ultrabasic massifs).

B. Ostrosi, S. Qorlaze, H. Caslli, M. Ylli — Klasifikimi gjenetik — industrial i vendburimeve të kromit, në vendin tonë, domosdoshmëria për rritjen e efektivitetit të punimeve gjeologo-zbuluese

149


(Industrial-genetic classification of chromium deposits of our country. The necessity of the growth of effectiveness of the prospection works).

- L. Langora, F. Duli, Xh. Sharra, H. Casli, A. Rrënja, P. Korçana, Ll. Prenga, A. Lulo, N. Likaj, Dh. Gjevreku** — Efektiviteti i përdorimit të metodave komplekse gjeologo-gjeofizike sipërfaqësore e nëntokësore për kërkimin-zbulimin e mineralit të kromit 159
(The effectiveness of the use of complex surface and drill — hole geological-geophysical methods for the prospection of chromium).
- R. Kamberi, B. Ostrosi, M. Ylli, S. Qorlaze, N. Osmani, G. Beqiraj, Gj Gjura** — Vlerësimi gjeologo-ekonomik i vendburimeve të mineraleve të dobishme të ngurta 173
(Geological — economic estimation of the ore deposits).
- V. Bezhani, I. Turku, M. Zaçja, T. Deda, D. Shtjefanaku, L. Hoxha, R. Kambe-raj** — Mineralizimet e bakrit në vullkanitet e Mirditës Qendrore. Pozicioni stratigrafik, gjeneza, perspektiva 181
(Copper mineralization in the volcanics of the central Mirdita. Stratigraphic position, genesis and perspective).
- F. Bakalli, A. Kodra, E. Delaj, I. Milushi, M. Shabani, M. Spaho, M. Godroli, P. Theodhori, R. Selimi** — Tiparet themelore të ndërtimit të formacionit vullkano-sedimentar të jurasikut të sipërm dhe drejtimet e kërkimit të mineralizimit të bakrit të pasur 191
(The principal features of the Upper Jurassic volcanosedimentary formation and the prospection directions for Cu-rich mineralizations).
- M. Zaçaj, A. Çina, M. Shallo, H. Pulaj, R. Hyseni** — Mineralizimet hidrotermale damarore, kuarc-sulfur të sekuencës gabroplagiogranitike, kompleksi ofiolitik i Albanideve 201
(Hydrothermal veiny quartz sulphide mineralization of gabbroplagiogranite sequence. Albanide's ophiolite complex.).
- R. Avxhiu, A. Frashëri, A. Zajmi, P. Alikaj** — Disa drejtime në përsosjen e kompleksit të metodave elektrometrike në kërkimin e xeherorëve sulfurë të bakrit 213
(Some directions on the perfection of the complex electrometric methods for the prospection of copper sulphide ores).
- K. Gjata, Q. Aliaj, O. Lika, P. Laze, V. Nasi, R. Bega, F. Balli** — Premisat gjeologjike të kërkimit të mineraleve të rrallë në vendin tonë 223
(Geological premises for the prospection of the rare metals in Albania).
- A. Grazhdani, Sh. Aliaj, H. Tuzi, V. Hoxha** — Tektonika tërthore në Albanidet dhe mineralizimet e reja të lokalizuara në të 235
(Transversal faults and new mineralization localized in them).
- Ll. Dimo, P. Pashko, P. Vaso, P. Kita, N. Çili, P. Bibaja, A. Palko J. Adhami** — Pellgjet qymyrorë dhe perspektiva e tyre 249
(Coal — bearing basins of Albania and their perspective).

P. Vaso, S. Duni — Klasifikimi industrialo-morfologjenik i lëndëve bituminoze të vendit tonë	259
<i>(Industrial — morphogenetic classification of the bituminous substances of our country).</i>	
E. Pumo, F. Arkaxhiu, P. Jani, S. Burri, M. Koçi — Situata gjeologjike për-xeherorët e Fe-Ni e Nikelit — Silikat, dhe detyrat për të ardhmen	267
<i>(Geological situation of Fe — Ni and Nickel — Silicate ores and the tasks for the future).</i>	
A. Serjani, S. Duda, R. Hysi — Fosforitet zonës Jonike, mundësitë e pasurimit dhe shfrytëzimit të tyre	277
<i>(Phosphorites of the Ionian zone, thier enrichment and exploitation).</i>	
A. Tërshana, I. Turku — Karakteristikat gjeologo-petrografike të disa shkëmbinjve dhe mineraleve industriale	291
<i>(Geological — petrographical features of some industrial rocks and minerals).</i>	
B. Eftimi, I. Tafilaj, G. Bisha — Rajonizimi hidrogjeologjik i Shqipërisë	303
<i>(Hydrogeologic division of Albania).</i>	
K. Karabina, E. Leka, Xh. Aliçka, K. Rate — Përsosja e përmirësimit teknologjik të shpimit — kusht për plotësimin e detyrave në kërkimin — zbulimin e mineraleve të dobishme	317
<i>(Improvement drilling technology — A principal factor to grow the prespection effectiveness).</i>	
KUMTESA TË PJESËMARRËSVE NGA VENDET E HUAJA	
<i>(Papers of the participants from foreign countries).</i>	
Marfa Zheljaskova — Panajotova — Vermikulites in Bulgaria '	323
<i>(Vermikulitet e Bullgarisë).</i>	
Dr. Endre Dudich — What is the International Geological Correlation Programme (IGCP)?	330
<i>Ç'farë është Programi i Bashkëpunimit Gjeologjik Ndërkombëtar, IGCP)?.</i>	
MBLEDHJA E PARË E SHOQATËS TË GJEOLOGËVE TË SHQIPËRISË	333
<i>(The first meeting of the association of the Albanian geologists).</i>	
— Fjala e rastit nga F. Bakalli, përgjegjës sektori në Komitetin e Shkencës dhe Teknikës	335
<i>(The occasional speech of F. Bakalli, chief of the Sector at the Committee of Science and Technique).</i>	

DISKUTIME — (Discussions).

A. Serjani — Krijimi i shoqatës na ngarkon me përgjegjësi morale e profesionale	339
<i>(The foundation of the Association puts forward new moral and professional responsibilities).</i>	
A. Papa — Shoqata ka detyra të mëdha	341
<i>(The Association before the important tasks).</i>	
— Këshilli dhe Kryesia e Shoqatës	343
<i>(Council and the Presidency of the Association).</i>	
— Statuti i Shoqatës	344
<i>(Statute of Association).</i>	



KUMTESA**DISA TIPARE KRYESORE TË METALOGJENISË
SË SHQIPËRISË**

Grupi i autorëve të monografisë dhe të hartës metalogjenike të Shqipërisë, në shkallë 1 : 200 000. (Referuar nga M. Shallo).

H Y R J E

Tiparet themelore të metalogjenisë së Shqipërisë janë pasqyruar në Hartën Metalogjenike të RPSSH në shkallën 1 : 200 000 dhe në monografinë «Metalogjenia e Shqipërisë», që përfaqësojnë sintezën shkencore të arritjeve të rëndësishme në fushën e kërkimit, zbulimit dhe të studimit të mineraleve të dobishme të vendit tonë dhe të përgjithësimeve gjeologjike krahinore.

I — Vështrim i shkurtër mbi gjeologjinë e Shqipërisë

Albanidet janë pjesë përbërëse e harkut Apenino-Dinarido-Albani-do-Helenid, që ndërton pjesën jugore të brezit orogjenik të Alpideve mesdhetare. Ata karakterizohen nga zhvillimi i gjërë i formacioneve karbonatike, terigjene e evaporitike si dhe nga zhvillimi i fuqishëm i magmatizmit, sidomos atij ofiolitik.

Në evolucionin gjeotektonik të tyre evidentohen: faza e vonshme e tektogjenezës varisike, riftëzimi i hershëm alpin në triasik, hapja oqeanike gjatë jurasikut, fazat e tektogjenezës së kufirit jurasiko-kretak, të mbarimit të kretakut, fundit të eocenit, oligocenit, paratorntonianit e pliokuaternare, është karakteristik migrimi i tektogjenezës në kohë e hapësirë nga lindja në perëndim. Veprimtaria magmatike shprehet kryesisht me vullkanitet acide e bazike të serisë normale-subbalkalinore të ordovikian-devonianit, vullkanitet bazike, mesatare e acide subbalkalinore të triasikut të poshtëm e të mesëm, ofiolitet jurasike të tipit «perëndimor» e «lindor», që supozohen të formuar si rezultat i hapjes oqeanike dhe i subduksionit intraoqeanik, gjatë jurasikut të mesëm e të sipërm, në buzën perëndimore të mikropllakës së Korab-Pelagonisë, të pavarur nga ofiolitet e Vardarit.

Struktura e Albanideve është e ndërlikuar nga rrudha të rendeve të ndryshme, me shtrirje kryesisht afromeridionale e përmbysje perën-

Janë evidentuar një sërë nivelesh qymyrmajtëse: Oligocenik, mio-cenik e pliokuaternar.

Në bilancin e mineralmbajtjes së vendit tonë duhet të gjejnë pasqyrim më të plotë, me futje në qarkullim ekonomik më të gjërë lëndë të para të tilla, si dunitet e freskët, xhamet vullkanike, materialet e ndërimit e gurët dekorativë, shkëmbinj të ceolitike, shkrifërimet e moshave të ndryshme etj.

L I T E R A T U R A

- I.S.P.GJ. — I.G.J.N. (1983 — Harta Gjeologjike e RPSSH në shkallë 1 : 200 000. (1982) — Gjeologjia e Shqipërisë, Arkivi i I.S.P.GJ. Tiranë.
- I.S.P.GJ, I.G.J.N, F.G.J.M (1985) — Harta tektonike e RPSSH në shkallë 1 : 200 000. Arkivi i ISPGJ, Tiranë. (1985) — Tektonika e Albanideve. Arkivi i ISPGJ, Tiranë.
- Grup autorësh (1989) — Harta metalogjenike e RPSSH në shkallë 1 : 200 000. Arkivi i ISPGJ. Tiranë. (1982) — Metalogjenia e Shqipërisë. Arkivi i ISPGJ. Tiranë.
- Bezhani V. etj. (1980) — Prognoza e bakrit e rajonit Mirditë-Pukë-Kukës.
- Çina A., Caslli H., Goci L. (1986) — The Chromites in the ophiolites of Albanides in Chromites; Athens.
- Dimo Ll. (1989) — Kushtet e formimit e shkalla e qymyrëzimit të qymyreve të RPSSH dhe perspektiva e tyre. Disertacion.
- Grazhdani A. (1987) — Metalogjenia e thyerjeve tërthore të Albanideve. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 2, Tiranë.
- I.G.C.P. (Project 197) (1987) — Metallogenetic maps of the ophiolite belts of the NE Mediterranean. Compiled by S. Karamata.
- I.U.G.S.; C.G.M.W. (1984) — Exploratory memior of the Metallogenic Map. of Europe and neighbouring countries, 1 : 2.500.000.
- Pumo E. (1985) — Lateritet (monografi). Tiranë.
- Serjani A. (1988) — Epokat fosforogjenike dhe depozitimet fosforitmbajtëse të vendit tonë. Bul.Shk.Gjeol. Nr. 1.
- Shallo M. (1980) — Petrologjia e shkëmbinjve magmatikë të Mirditës Qendrore dhe mineralizimet sulfure lidhur me ta. Disertacion.
- Shallo M., Kote Dh., Vranai A., Premti I. (1985) — Magmatizmi ofiolitik i RPSSH. Arkivi i I.S.P.GJ, Tiranë. (1989) — Disa veçori petrologjike të ofioliteve të Shqipërisë, Bul. Shk. Gjeol. Nr. 1.
- Shallo M., Çina A., Dobi A., Çili P., Premti I., Ruli Q. (1989) — Petrologjia e shkëmbinjve ultrabazikë të brezit lindor dhe mineralizimi kromitik lidhur me ta. (Masivi ultrabazik i Bulqizës). Arkivi i I.S.P.GJ. Tiranë.
- Xhomo A., Pashko P., Meço S (1985) — Stratigrafia e depozitimeve paleozoike të zonës së Korabit dhe premisat mineralmbajtëse të tyre. Tiranë.

SOME MAIN FEATURES OF THE METALLOGENY OF ALBANIA

Albanides are a component part of the Appennines-Dinarides-Albanides-Hellenides chain, which build up the southern part of the organic belt of the Mediterranean Alpides. They are characterized by a wide development of the Paleozoic, Mesozoic and Kainozoic carbonate, terrigenous, evaporitic, more seldom metamorphic formations and of the Paleozoic, Lower-Middle Triassic, Jurassic and later magmatic ones. The ophiolites have a complete formational representation. The «western» ophiolites with the plagioclastic sequence and «eastern» ones with the pyroxenic sequence can be distinguished. It is supposed that they are formed due to the oceanic spreading followed by the intraoceanic subduction during Middle-Upper Jurassic at western margin of the Korab-Pelagonian microplate. The geotectonic evolution of the Albanides is expressed by the latest Variscian stage, early alpine rifting in Triassic, Jurassic oceanic spreading, the stages of the tectogenesis of the alpine cycle: of the Jurassic-Cretaceous, Eocene, Oligocene, pre-Tortonian and Plio-Quaternary one. The migration of tectogenesis in time and space from east towards west is verified. The structure of Albanides is folded and complicated by fault, thrusts-overthrusts, subvertical faults.

The following tectonic zones have been distinguished in Albanides from east to west: Korabi zone, consisting of Paleozoic and Mesozoic formations; Mirdita zone with the ophiolitic subzone and peripheral Mesozoic carbonate one; Krasta-Cukali zone, composed mainly of pelagic Mesozoic deposits and Paleogene flysch. The Cukali, Krasta, Dibra and Vermoshi subzones are distinguished within it; Albanian Alps zone with Malësia e Madhe subzone composed of the neritic carbonates and Valbona one composed of the Jurassic pelagic sediments; Kruja zone consisting of the Cretaceous-Eocene neritic carbonates and the Oligocene flysch; Ionian zone with mainly pelagic Jurassic — Eocene formations and the Oligocene flysch; Sazani zone with the Mesozoic neritic carbonates; Albanian-Thesalian and Pre-Adriatic basins and the diapirs of Dumre, Peshkopi etc.

The problems of the metallogeny of Albania have been treated in several reports and scientific publications.

A synthetic presentation of the metallogeny of Albania is reflected in the Metallogenic Map of PSR of Albania scale 1 : 200.000 and in the respective monography (1989).

While the Caledonian and Variscian cycles are weakly expressed in the metallogenic evolution of Albanides, the Alpine one is fully represented by some metallogenic stages.

The endogene (magmatic, hydrothermal and telethermal), exogene (of the weathering crust, sedimentary-mechanical, biochemical and chemical) and, more seldom, metamorphic mineralizations occur in Albanides.

The Albanian territory represents an independent metallogenic province in the Mediterranean-Alpine metallogenic belt with several lowest degree metallogenic units, amongst which, the most important are they linked with the ophiolites. In the «eastern» ophiolites are distinguished; the ore belts of the mantle and cumulate chromites of mainly metallurgic type with Cr : Fe about 3-4 and Cr : Al about 4-5 and of the Platinum Group Elements which belong to the ultrabasic rocks of the eastern belt; the ore belt of the volcanic sulphide mineralization of Mirdita with the pyritous, copper-bearing sulphide and zinc-bearing sulphide subformations be-

linked with the basalt-dacitic volcanites (Si over saturated low Ti and low K tholeiites) with the petrological features similar to the marianite-boninite series and sheeted dykes, with well expressed vertical zonality and the intensive development of hydrothermal metasomatites; the ore belt of the veiny quartz sulphide mineralization belonging to the gabbro plagiogranite rocks (norites, gabbro-norites, quartz diorites, plagiogranites) of the eastern ophiolites. In the «western» ophiolites are distinguished: the ore belt of the mantle and cumulate chromites, mainly of the refractory type with Cr:Fe about 3 and Cr:Al about 2, belonging to the western belt of the ultrabasic rocks; the ore belt of the vanadium-bearing titanomagnetites and quartz-sulphide ores belonging to the gabroic (troctolites, gabbros, ferrogabbros) and gabbro-diabase, rocks of the western ophiolites and the sulphide volcanogenic mineralization belt related to the basaltic pillow lavas (undersaturated high Ti tholeiites), similar to the MOR basalts. The volcano-sedimentary serie of the ophiolite's periphery represents an individual metallogenic unit of the most interest for the volcano-sedimentary ores. The mineralizations of asbestos, talc, magnesites etc. are also related to ophiolites.

The belt of the iron-nickel and nickel-silicate lateritic ores of the eastern belt of the ultrabasic rocks is of a special interest amongst the metallogenic units of the exogene mineralization. The age of the sedimentary cover is of the Barremian-Aptian (at the most northern sectors), of the Upper Cretaceous (at the central ones) up to the Middle Eocene (at the southern ones); the lacks of laterites in the western ophiolites is conditioned by the sedimentation of the Tithonian-Lower Cretaceous deposits.

The mineralization of bauxites in the Albanian Alps zone occurs in the Ladinian-Upper Triassic boundary and Kimmeridgian-Tithonian one; in some stratigraphic levels in the Mirdita zone, whereas in the Kruja zone is of Paleogene-Neogene age.

The phosphorite mineralization in the Ionian zone is localized in Lower-Middle Jurassic and Upper Cretaceous. The mineralization of salts is related with the evaporites in the Ionian zone and Pre-Adriatic basin. The brown coals are of the Oligocene, Neogene and Plio-Quaternary age. The fresh refractory dunites, volcanic glasses, kaolines, some raw materials etc. are also included in the mineral-bearing of Albania.

EVOLUCIONI MESOZOIK I ALBANIDEVE TË BRENDSHME, FAZAT E RIFTËZIMIT DHE ZGJERIMI OQEANIK MIRDITOR

Alaudin Kodra Ministria e Ind. Min. dhe Energjetikës
Kadri Gjata Instituti S.P. të Gjeologjisë

H Y R J E

Studimet shumëvjeçare, të kryera në Albanidet e brendshme, lejojnë përcaktimin e disa stadeve kryesore të evolucionit të tyre, ndër të cilët sidomos spikatin fazat e riftëzimit triasik dhe jurasik, diferencin e theksuar i basenit të sedimentimit gjatë ladinianit të vonshëm deri në liasik në kurrizore platformike, me kore të trashë kontinentale dhe në hulli pelagjike me kore të hollë kontinentale, si dhe zgjerimi oqeanik mirditor në jurasikun e vonshëm. Njohja e këtyre stadeve të zhvillimit ndihmon për interpretime gjeologjike dhe vlerësime metalogjenike më të avancuara e më të thelluara.

Albanidet bëjnë pjesë në sistemin e rrudhosur alpin mesdhetar (fig. 1). Në vartësi të mungesës ose pranisë të fazave orogjenike të hershme (jurasike-kretake), Albanidet ndahen në të jashtme dhe të brendshme. Ndërsa Albanidet e jashtme karakterizohen nga një sedimentim i vijueshëm nga triasi në paleogen, Albanidet e brendshme shquhen nga zhvillimi i transgresionit dhe diskordancës së kretakut të poshtëm. Po ashtu, veçanërisht karakteristike, është prania e formacionit vullkano-sedimantar të jurasikut të sipërm, së bashku me magmatizmin e hershëm që e shoqëron, si dhe zhvillimi i ansamblit të fuqishëm ofiolitik të Mirditës.

Ndarja më e hollësishtme e Albanideve në zona e nënzona strukturore-faciāle e tektonike, si dhe bashkëlidhja e tyre me ato të Jugosllavisë e Greqisë është sintetizuar në fig. 2 dhe në pasqyrën 1.

Evolutioni mesozoik

Zonat e brendshme të Albanideve përmbajnë prerje të plota e të ruajtura mirë, që sjellin informacion për studimin e historisë së zhvillimit gjeodinamik para hapjes oqeanike mirditore, gjatë hapjes, si dhe pas mbylljes së oqeanit mirditor. (fig. 3).

1. Gjatë permo-verfienianit ka qenë zhvilluar mjedisi i një deti të cekët, me depozitim të konglomerateve e ranorëve të kuqërremtë, që

— Tjetri, me dy krahina oqeanike, të Vardarit dhe Mirditës, të ndara nga mikroblloku i Korab-Pelagonisë — Golias, të inkuadruara në mikropllakën Apuliane — Taurike (fig. 4). Në verilindje të tyre sipas mjaft autorëve shtrihej paleotetisi (Vergely P. 1984). Për rajonet e Taurideve, për këtë model janë shprehur Sengeor dhe Yillmaz (1981) etj. Për Dinariidet, Albanidet dhe Helenidet, për modelin e dytë janë shprehur shumica e studjuesve (Gjeol. Shqip. 1982, Kodra A., Gjata K. 1982 etj. Karamata S. 1979, Vergely P. 1977, 1984 etj.).

Në bazë të studimeve të kryera në Helenidet, të bazuara mbi konceptimet e mësipërme të vendosjes së ofioliteve, nga disa autorë nuk pranohet idea e obduksionit mesozoik nisur nga një ose disa basene oqeanike të zonës Vardarit dhe (ose) të Othrisit (Smith A.G., Spray J.G. 1983). Ata supozojnë që dublimi i brezave ofiolitike është rezultat i një megazhvendosje të majtë, mbi 700 km, gjatë jurasikut. Ne arrijmë në një mendim të përbashkët me këta autorë, për formimin e ofioliteve të Mirditës në perëndim të mikrobllokut Korabian, por në bazë të shqyrtimit të një literature të gjërë për rajonet vardariane, na duket e pabesueshme hipoteza për megazhvendosje të majtë (Mercier J.L. 1966, Bebien J. etc. 1980, Ferriere J. 1976, Mercier J.L. Vergely P. 1977, Vergely P. 1977, 1984, Mavridis A. 1977 etj.). Studimet paleogjeografike e tektonike tregojnë qartë se gjatë jurasikut të sipërm, në lindje dhe në perëndim të zonës së Korab-Palegonisë kanë ekzistuar dy basene komplekse me kore oqeanike me rëndësi të ndryshme.

Përveç argumenteve paleogjeografike e strukturore, pavarësinë e oqeanit mirditor nga ai vardarian e mbështesin edhe një sërë të dhënash të tjera të karakterit të përgjithshëm.

Ofiolitet e zonës Mirdita përfaqësojnë një segment kompakt të litoferës oqeanike të Jurës së sipërme, me sipërfaqe rreth 4200 km². Në bazë të dhënave gjeologo-gjeofizike, trashësia e ofioliteve lëviz në kufijtë nga 1-2 km në pjesët perëndimore deri 6-12 km në pjesët qendrore — lindore (Langora Ll etj. 1983), duke u paralelizuar me manifestimet e fuqishme të ofioliteve të brezit mesdhetar, siç janë ato të Omanit, Qipros etj. Bashkësia ofiolitike e Albanideve individualizohet tepër qartë në pikëpamje petrologjike me zhvillim të plotë të gjithë pjesëtarëve litologjikë, si dhe përbën një unitet të vetëm strukturor, jo shumë të cënuar nga tektonika horizontale dhe luspëzimet eventuale. Këto veçori të tyre, si dhe bashkëshoqërimi i ngushtë dhe i natyrshëm me formimet dhe mjedisin paraofiolitik, pasqyrojnë qartë tiparet parësore e origjinale të një baseni oqeanik me zhvillim kompleks vetiak dhe të pavarur.

L I T E R A T U R A

Bezhani V. etj. — Bul. Shk. Gjeolj. Tiranë, 1983.

Delaj E. etj. — Bul. Shk. Gjeol. Tiranë 1985

Grup autorësh — Harta gjeologjike e RPSSH, Shk. 1 : 200 000, 1983

Grup autorësh — Gjeologjia e Shqipërisë, 1982

Grup autorësh — Harta Metalogjenike e RPSSH, 1989

Grup autorësh — Harta Tektonike e RPSSH, 1984

Gjata K., Kodra A., Mustafa F. etj. — Studim tematik, Tiranë 1986

- Kodra A., Delaj E., — Përmb. Stud. Nr. 4, Tiranë, 1976.
- Kodra A., Gjata K., — Bul. Shk. Gjeol. 2, Tiranë 1982
- Kodra A., Peza L., Pirdeni A., Gjata K. — Bul. Shk. Gjeol. Nr. 4, Tiranë, 1984
- Kodra A. — Disertacion, Fondi Q. Gjeol. Tiranë 1986
- Kodra A. — Bul. Shk. Gjeol. Nr. 4, Tiranë, 1987
- Kodra A., Hallaçi H., Pezhani V., Gjata K., Çakalli P. — Geol. Congress of Turkey, Ankara, 1988.
- Kodra A. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 4, Tiranë, 1988
- Kodra A., Gjata K., Jahja B., Godroli M. — XIV Congress CBGA, Sofia 1989.
- Langora Ll., Bushati S., Likaç N. — Bul. Shk. Gjeol., 3, Tiranë 1983
- Shallo M., Kodra A., Gjata K. — In Troodos ophiolite and oceanic lithosphere, Nicotia, 1989.
- Shallo M., Kote Dh., Vranai A., Premti I. — Bul. Shk. Gjeol., 1.2: Tiranë, 1989;
- Xhomo A., Pashko P., Meçe S. — F.Q.Gj 1985
- Aubouin J., B.S.G.F, (7^e), 1, XIX, Paris, 1977
- Bebien J., Onnestetter M., Vergely P. — Ofioliti, sp. issues 2, Firenze. 1980.
- Bernouilli Q. Laubsecher H., Eclogae Geol. Helv. 65, 1972.
- Bjorlykke A., Ihlen P.M., Terra abstr. V. I, N6, 7. EUG5, Strasbourg, 1989.
- Dercourt J. etc. BSGF (8) 1,5, Paris 1985.
- Ferriere J. Ann. soc. geol. Nort. vol. 96, 2, 1976.
- Mitchell A.N.G., Garson M.S.; Ac. Press INC. London, 1984.
- Karamata S., Ofioliti, 1979.
- Mavriadis A., VI Coll. Aegean region, Athens, 1977
- Macdonald K.C., Fox P.J., Perram L.J., Eisen M.F. etc., Nature, vol. 335, 15 sept, 1988
- Mercier J.L. These d'Etat Paris, 1976.
- Mercier J.L. Vergely P., BSGF (7), XIX, 1, Paris, 1977.
- Moores E.M., Robinson P.T., Malpas J., Xerophonotos C., Geology v. 12 1984.
- Nicolas A., Ceulener G., Boudier F., Misseri M. — Tectonophysics, 151, 1989.
- Pamiç J. Geol. Glas (Sarajevo). 8, 1963.
- Pamiç J., Int. Union Geol. Sci, A, 4, 1974.
- Ramponoux J. These d'Etat, Paris, 1973,
- Ricou L.E. — Coll -5, Mem: BRGM, 115, 1980.
- Sengor A.M., Yillmaz, — Tectonophysics, 1981
- Smith A.G., Spray J.G., Ophiolites, 1983.
- Vergely, P., VI. Coll. Aegean reg., Athens, 1977
- Vergely P., These d'Etat Paris, 1984.

MESOZOIC EVOLUTION OF THE INNER ALBANIDES, RIFTING STAGES AND THE MIRDITA'S OCEANIC SPREADING

The Albanides belong to the folded alpine-mediterranean system (fig. 1). The Outer and Inner Albanides can be distinguished depending on the lack or presence of the early orogenic stages (Jurassic-Cretaceous).

The Outer Albanides are characterized by a successive sedimentation from the Triassic to Paleogene. The Inner Albanides distinguish by a development of the Lower Cretaceous transgression and unconformity and the presence of the Upper Jurassic volcano-sedimentary formation. The associating early magmatism and the

development of the vigorous ophiolitic ansamble of Mirdita is also most characteristic.

In fig. 2 is seen a more detalized division of Albanides into structural-facial and tectonic (microblocks) zones and subzones and their correlation with the respective ones in Yugoslavia and Greece.

The Mesozoic rocks are widespread in Inner Albanides. In figs. 3 and 4 is shown the correlation scheme of the summarized litostratigraphic columns and the principal stages of the Mesozoic evolution:

1- The alpine cycle in the Inner Albanides starts with the setting under shallow sea conditions of the Permo-Verfenian conglomerates-sandstones on the Paleozoic schists. The calc-alkaline volcanism of alkaline tendency lies on this formation. The mainly carbonate shallow sea sedimentation has been continued during the Late Verfenian-Early Anisian.

2- During the Late Anisian, under the condition of an extensional regimen, occurred the continental crust rifting and the formation of the graben-like basins associated by the volcanic eruptions and deep sea sediments (Porphyrite-Radiolaritic Formation). This stage of the continental crust rifting in Albanides did not reach to develop up to the oceanization of the basin.

3- The time from the Late Ladinian to the Liassic has been characterized by a remarkable differentiation of the sedimentation basin. East of the Sazani-Ionian-Kruja, still undifferentiated carbonate platform can be distinguished several platformic trenches and ridges. From west to east they are: Krasta-Cukali trench, Hajmeli ridge, Qerret-Miliska trench (with the Fierza upwelling in the middle part), Gjallica ridge and Çaje and Kollovozi trenches (with the Malësia e Korabit upwelling in the middle part?).

4- The important events occurred during the Jurassic in Inner Albanides: the maximum thinning of the continental crust, its rifting and the formation of the Mirdita's graben-like structure associated with most different early magmatism (ultrabasic, basic, intermediate-acid to acid) and the formation of sinrifting and post rifting (volcano-sedimentary) megasequences.

5- The Mirdita's oceanic spreading was a most important moment in the evolution of Albanides. Firstly has been developed the western oceanic spreading with low velocity, limited thermal flux, lower degree partial melting of the astenospheric mantle at a great depth, giving mainly lherzolitic sequences similar to the primitive mantle. Successively, in the more eastern sectors is supposed the development of the more vigorous astenospheric fluxes with high degree partial melting leading to the fast spreading and giving the ophiolites of the eastern belt with the potent mainly harzburgitic tectonite sequences and the dunite-wehrlite-pyroxenite-banded gabbro cumulates, isotropic gabbros, quartz diorites, plagiogranites, sheeted dyke complex, lower and upper lavas with the radiolarites and the argillite-detritus pack at the upper part.

6- During the Early Tithonian-Hauterivian time, as a result of a compressional regimen linked with the beginning of the Southern Atlantic opening, occur the closing of the Mirdita's ocean, the obduction of ophiolites on the continental margins, mainly in the western flank, less in the eastern one. The amphibolites, micaeous and green schists have been formed as a result of this emplacement.

The ophiolite setting is associated with the formation of the Tithonian-Valanginian clastic-marly sediments.

A. Kodra, K. Gjata

7- A complete new paleogeography is stabilized in the Inner Albanides (Kodra, A., Gjata, K., 1982, etc.) by the transgression and the Cretaceous discordance (Barremian).

In the debate on the existence or no (and from what time) of a microcontinent, independently from the Euro-Asiatic and African plates, numerous data allow the reconstruction of a believed modelling of development of the Dinarides-Albanides-Hellenides belt with two regions with oceanic crust (Mirdita and Vardar) separated by the Korab-Pelagonian — Golia microblock.

LIGJËSITË E PËRQËNDRIMIT TË MINERALIZIMIT KROMITIK NË MASIVËT E BREZIT LINDOR TË SHKËMBINJVE ULTRABAZIKË

Halil Hallaçi Ministria e Industrisë, Minierave dhe Energjitikës
Sefedin Qorlaze I.S.P. të Gjeologjisë;
Makbul Ylli I.S.P. të Gjeologjisë;
Llambi Langora N. Gjeofizike;
Veip Gjoni, Filiali i Kromit Burrel;
Kristaq Dhima N.Gj. Pogradec;
Ramazan Ceni N.Gj. Burrel;
Sefedin Shabani N.Gj. Bulqizë;
Vaxhid Tahsimi I.S.P. të Minierave

H Y R J E

Në këtë kumtesë jemi përpjekur të pasqyrojmë arritjet e gjeologëve tanë në drejtim të përcaktimit të ligjësisë të përqëndrimit të mineralizimeve të kromit. Vendi ynë bën pjesë në provincën metalogjenike alpine, të përfaqësuar kryesisht nga kompleksi ofiolitik dhe mineralizimi që lidhet me të. Krahas tipareve të përgjithshme për këtë njësi, vendi ynë paraqet edhe tiparet individuale që shprehen në intensitetin e shfaqjes së formacioneve xeherore, në përmasat dhe në pozicionin tektonik të vendosjes së mineralizimit.

Të dhëna gjeologo-strukturore dhe mineralizimi kromitik

Përbërësit kryesorë të ofioliteve të Albanideve janë shkëmbinjtë ultrabazikë. Ata zenë një sipërfaqe prej rreth 2850 km² dhe vendosen në trajtën e dy brezave (fig. 1):

- a- brezilindor
- b- brezi perëndimor

Brezat kanë shtrirje juglindje-veriperëndim. Sejcili brez përbëhet nga disa masivë, me dalje sipërfaqësore që luhetet nga 110 km² deri në 440 km². Në pjesën ndërmjet dy brezave takohen shkëmbinjtë e serisë gabro-plagjiogranite e të asaj vullkanogjene dhe formimet më të reja të formacioneve sedimentare. Në pjesën anësore të masivëve ultrabazikë ndeshet formacioni vullkanogjeno-sedimentar jurasik dhe ai karbonatik i T₃.

këtë nivel është e hapur dhe e mirë, si në shtrirje e në gjërësi tej kontureve të njohura të vendburimeve ekzistuese etj.

Mbi këtë nivel kryesor në masivin e Bulqizës, Tropojës, Shebenik-Pogradecit vërehet edhe zhvillimi i një niveli tjetër (rreth 250-300 m. më sipër) mineralizimi, por trupat xeherorë kanë forma thjerrzore, përmasa të vogla e përmbajtje relativisht të ulët.

2. Niveli i dytë i mineralizimit kromitik është i pranishëm në facien dunit-harburgitike (Thekna, Tërnova, Liqeni Dervishit, Shkalla, Lugu i Gjatë, Kalimashi 2, Kam 2-4-5, kilometri i 4 etj.). Lokalizimi i mineralizimit përfaqësohet nga disa trupa xeheror paralelë, me përmasa të vogla, mesatare e deri të mëdha në shtrirje dhe deri në 400 m rreth rënie. Trupat xeherorë kanë trajta të ndryshme damaroro-pllakore, thjerrzore, shtyllore etj. Ndërprerjet gjenetike në shtrirje e rënie janë të theksuara. Perspektiva e kërkimit edhe për këtë nivel mineralizimi është e çelur, respektivisht me zhvillimin në gjërësi e shtrirje për secilin masiv. Përveç këtyre niveleve kryesore të xeherizimit podiform, të pranishëm në tektonitet, në pjesën më të thellë të tyre (facia harburgitike) takohen edhe shfaqje e objekte të mineralizimit «mbetës» (zjarrdruues), por që në stadin aktual nuk paraqesin perspektivë të konkretizuar.

3. Mineralizimi i tipit stratiform është karakteristik për sekuencën kumulate (dunit-kumulative). Ai përfaqësohet nga trupa xeherore stratiforme me përmasa të vogla (Guri Mekës, Kaptinë) deri mesatare (Krasta — Lugu i Thellë etj.) e deri të mëdha (Kalimashi -1). Përfaqësohet nga disa nivele, ku mund të përvijohen ato më kryesoret si ai i Kalimash-1 — Krasta — Lugu i Thellë etj. Xeherori është kryesisht për pasurim. Perspektiva e shtimit të rezervave, si për vendburimet ekzistuese, ashtu për gjetjen e vendburimeve të reja është e çelur në përputhje me përhapjen e facies dunitike kryesisht në pjesët perëndimore të masivëve ultrabazike të brezit lindor.

4. Me sekuencën kumulate (facia e peridotiteve plagjioklazike) që vendoset në pjesët e sipërme të kumulateve takohen edhe mineralizime të tipit zjarrdruues (vendburimi Cërrujë në masivin e Bulqizës e disa shfaqje e objekte në masivët e brezit perëndimor). Sasia e rezervave të zbuluara deri tani është relativisht e vogël, por perspektiva e vlerësimit të tyre është e çelur.

L I T E R A T U R A

1. Enver Hoxha 1980 — Përparimi i vendit tonë është i pandarë nga zhvillimi i shkencës dhe teknikës (Fjala mbajtur në plenumin e 8-të të KQ të PPSH).
2. Ramiz Alia 1986 — Raport në Kongresin e 9-të të PPSH.
3. Adil Çarçani 1986 — Raport mbi direktivat e Kongresit të 9-të të PPSH për planin e tetë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë e kulturës në RPSSH. Për vitet 1986-1990.
4. Grup autorësh 1983 — Gjeologjia e Shqipërisë.
5. » » 1989 — Metalogjia e Shqipërisë.
6. » » 1989 — Studim mbi problemet e metodike të mineralit të kromit.
7. » » 1989 — Studim tërësor tekniko-ekonomik mbi perspektivën e zhvillimit të industrisë kromit deri në vitin 2000 (1989).

8. » 1989 — Rrugët për rritjen e efektivitetit të punimeve të kërkimit dhe zbulimit për mineralin e kromit në RPSSH.
9. » 1984 — Magmatizmi ofiolitik i R.P.S.S.H.

THE REGULARITIES OF THE CONCENTRATION OF CHROMITIC MINERALIZATION IN THE ULTRABASIC MASSIFS OF THE EASTERN BELT

This paper provides the main achievements in the prospection of the chromium ore. Summarily is given the evolution of our geological knowledges about the main regularities of the concentration of chromium mineralization in the ultrabasic massifs of the Eastern belt.

The magmatic section consists of two sequences: tectonite and cumulate. Each of these sequences is characterized by a particular lithological-petrographical facies. The chromium mineralization is localized in the definite levels of the tectonite and cumulate sequence.

Apart from some similarities, the chromium-mineralization represents individual features which are typical from one massif to another one.

The main perspective levels and the further prospection orientation are also given here.

VENDOSJA E MINERALIZIMIT KROMITIK NË MASIVIN ULTRABAZIK TË BULQIZËS DHE VEÇORITË STRUKTUREORE TË VENDBURIMEVE

Shadan Stërmasi I.S.P. të Gjeologjisë,
Aleksandër Çina I.S.P. të Gjeologjisë,
Halil Hallaçi Min. Ind. Minierave dhe Energjitikës,
Bashkim Jahja Min. Ind. Minierave dhe Energjitikës,
Qemal Lena Filiali Kromit, Burrel,
Sulejman Alia Nd. Gjeol. Bulqizë,
Flamur Çollaku Nd. Gjeol. Burrel.

Karakteret e prerjes magmatike

Masivi i Bulqizës, me një sipërfaqe 350 km², është pjesë përbërëse e brezit lindor të shkëmbinjve ultrabazikë të vendit tonë. Ai ka potencialin krombajtës më të madh në vendin tonë.

Në ndërtimin gjeologjik të masivit marrin pjesë shkëmbinjtë ultrabazikë të sekuencës tektonike (mantelike), të përfaqësuar në pjesën më të madhe nga harzburgitet, më pak nga dunitet, të cilët mbulojnë she-shin më të madh të masivit, duke u vendosur në pjesët lindore e qendrore të tij, si dhe nga sekuencat kumulate dunitike, piroksenitike, trokto-lite e gabrore, të cilat vendosen në mënyrë diskordante mbi tektonitet, në pjesët perëndimore e jugore të masivit (fig. 1). Prerja magmatike nga poshtë lartë përbëhet: Nga harzburgite me ndërthurje të rralla dunitesh, me përmasa të vogla në shtrirje dhe në rënie. Këta shkëmbinj janë të freskët në nivelet e poshtme ose kanë shkallë të ulët serpentinizimi në nivelet e sipërme. Karakteristike për ta është sidomos metamorfizmi kataklastik, i shprehur me strukturat kataklastike, porfiroklastike mozaike, deri në formimin e perfiroklasteve, neoblasteve. Prania herë — herë e klinopiroksenit në pjesët më të thella u jep harzburgiteve pri-rje lercolitike. Prerja vijon me pjesën harzburgit-dunitike, ku përmasat dhe dendësia e thjerrzave dunitike rritet nga poshtë sipër. Krahas kësaj, rritet shkalla e serpentinizimit dhe shfaqet talkëzimi. Facia harzburgit-dunitike dhe mineralizimi që ajo përmban karakterizohen nga dukuria e rrudhohjes dhe nga ndryshimet litologo-faciale, si në planin gjatësor, ashtu dhe në atë gjërësor. Deri në majën e tektoniteve prerja vazhdon me pjesën dunit-harzburgitike, ku dendësia e thjerrzave dunitike e përmasat e tyre rriten së tepërmi, por gjithmonë në një mjedis harzburgitik. Dhe këtu vërehet dukuria e rrudhosjes, por e shprehur më dobët.




Fig. 9. Profil përgjithësues në v.b. Krastë-Lugu i Thellë.

A generalized schematic profile of the Krastë-Lugu i Thellë deposit.

torët litologjikë, strukturorë, mineralogo-petrografikë etj., të përmendur më lart, mbështesin gjërësisht intensifikimin e mëtejshëm të punimeve të kërkimit për gjetjen e objekteve të rinj dhe zgjerimin e atyre ekzistues.

LITERATURA

1. Çina A., Casili H., Goci L. 1986 — Chromites in the ophiolites of Albanides. (In: Chromites UNESCO IGCP-197. Project Metallogeny of ophiolites), Athens.
2. Çina A. 1987 — Mineralogjia e kromiteve të masivit ultrabazik të Bulqizës. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 3.
3. Çollaku F., Disha H. etj. 1987 — Raport gjeologjik me llogaritjen e rezervave të vendburimit Batër.
4. Dobi A. etj. etj. 1978-1980 — Raport mbi studimin tematiko-përgjithësues e kërkues i punimeve komplekse gjeologo-gjeofizike për prognozën krômmbajtëse të masivit ultrabazik të Bulqizës.
5. Jahja B., Keraj N., Gjoni V., etj. 1985 — Relacion gjeologjik i vendburimit «16 Tetori».

6. *Premti I., Stërmasi Sh., etj. 1986* — Studim mbi hapjen dhe konkretizimin e perspektivës së mineralizimit të kromit të pasur në zonën perëndimore të vendburimit Batër.
7. *Qorlaze S., Jahja B., Çina A., Shabani S., Balla B. 1981* — Studim përgjithësues për vlerësimin e perspektivës të zonës përreth vendburimit të Bulqizës.
8. *Qorlaze S. etj. 1986* — Studim mbi çeljen e perspektivës në krahun lindor të vendburimit Bulqizë për konkretizimin e mineralit të pasur dhe sqarimin e marrëdhënieve Bulqizë-Almarinë — Afër Liqej.
9. *Stërmasi Sh., Çina A., Gjoni V., Tërshana A., Alliu I., etj. 1988* — Studim tematico-përgjithësues-rilevues kompleks për përcaktimin e ligjësive të lokalizimit të kromit, hapjen e perspektivës dhe konkretizimin e objekteve në rajonin Bulqizë-Batër-Thekën.
10. *Stërmasi Sh., Çina A., Gjoni V., Tërshana A., Alliu I. etj. 1989* — Studim tematico-përgjithësues-rilevues kompleks për përcaktimin e ligjësive të lokalizimit të kromit, hapjen e perspektivës dhe konkretizimin e objekteve në rajonin Bulqizë-Batër-Thekën.
11. *Tashko A. 1976* — Disa dallime gjeokimike që vërehen brenda shkëmbinjve ultrabazikë. Përmb. Stud. Nr. 4.
12. *Shallo M., Çina A., Dobi A., Çili P., Premti I., Ruli Q. 1989* — Petrologjia e Shkëmbinjve ultrabazikë të brezit lindor dhe ligjësitë e përqëndrimit të mineralizimit të kromit.

THE DISTRIBUTION OF THE CHROMITIC MINERALIZATION IN THE BULQIZA ULTRABASIC MASSIF. STRUCTURAL FEATURES OF ORE DEPOSITS

The Bulqiza massif, the most important chromium-bearing one, belongs to the eastern belt of the ultrabasic rocks of our country.

The ultrabasic rocks of the mantle sequence, harzburgites and less dunites, constitute the greatest part of the massif and are situated in the eastern and southeastern part. The cumulate serie, dunites, pyroxenites, troctolites and gabbros are discordantly set on the tectonite one. These rocks occur in minor quantities and are localized in western and south western part (fig. 1).

The magmatic sequence, from bottom to top, is as follows: the harzburgites with the intercalations of rare dunite lenses. More above succede harzburgite-dunites. The dimensions and density of dunite lenses increase towards the top. It is observed that the degree of serpentinization increases as well. This part of sequence and mineralization situated within it is also strongly folded. The lithological-facial changes occur both, in latitudinal and longitudinal direction. Up to the topmost part of tectonites, the sequence continues with the dunite-harzburgite rocks, in which the density and the dimensions of the dunite lenses increase. However, the harzburgites are prevalent. Upwards appear dunite cumulate sequences succeeded by wehrlites, pyroxenites up to gabbroic rocks (fig. 2).

The Bulqiza massif has southeasterly-northwesterly general extension and consists of folded structures with southwesterly dipping. From northwest to southeast, the extension of the massif is made from submeridional to sublatitudinal and, up to latitudinal. From dhe Lugina e Vajkalit towards northwest and southeast, the massif underwent genetic uprising with 30-40° and 60-70° angles, respectively. Later, with smaller angles, successively is passed from the uprising onto the 15-20° gene-

tic dipping (fig. 3). The intensive development of the folding and fault tectonics are characteristic of the Bulqiza massif. Some asymmetric folded structures with northeasterly dipping are evidenced.

The most important ore deposits of the Bulqiza massif are Bulqiza, Batra, Thekna, Shkalla etc. The formation conditions of these deposits (temperature, depth), reflected in morphological features of bodies, textural-structural features of ores and in composition of chromite itself are different, according to the types and geologic setting of mineralization. Two main mineralization types can be distinguished in this massif: podiform and stratiform. The first is situated at different parts of tectonite sequence: from the deepest harzburgite + cpx part with Al-rich residual refractory chromitic mineralization to the middle harzburgite-dunite one with Cr-rich metallurgic chromitic mineralization up to the upper part of the tectonite sequence with Cr-rich metallurgic chromitic mineralization, but less important than that of the middle part of sequence. The second stratiform one is localized in the cumulate dunite sequences and consists of banded and disseminated Cr-rich type ores, but poor in contents. An another Al-rich mineralization of the refractory type is localized on the top of the cumulate ultrabasic sequence.

Në fillim të pesëvjeçarit të tetë 1986-1990, vetëm sa u përvijuan drejtimet e punës dhe u bë argumentimi teorik paraprak i tyre. Tashmë janë arritur rezultate konkrete nga shumë studime teorike dhe eksperi-

ti, do shërbejnë për zhytjen nëntokë të elektrodave ushqyese ose marrëse, për të rritur thellësinë e kërkimit. Për qëllimin e fundit, mund të projektohen dhe të shpohen puse pilot, me detyra strukturoro — kërkuese.

Zgjerimi dhe thellimi i bashkërendimit dhe i bashkëinterpretimit të të dhënave gjeologjike me informacionin e rilevimit gjeofizik dhe gjeokimik sipërfaqësor, me rezultatet e karrotazhit dhe të metodave të gjeofizikës nëntokësore, do të bëjnë një hop të ri cilësor në zbatimin e metodave gjeofizike e gjeokimike, në kërkimin e xeherorëve të bakrit në vendin tonë.

L I T E R A T U R A

1. Alikaj P. 1989 — Studimi spektral i dukurisë së polarizimit të provokuar në fushë kohe për dallimin e xeherorëve sulfurë me teksturë masivo-damarore. Disertacion.
2. Avxhiu R. 1989 — Studimi i rrugëve për rritjen e thellësisë së kërkimit të vendburimeve të bakrit me anën e metodës së pp në pjesën qendrore dhe veriore të zonës tektonike Mirdita. Disertacion.
3. Ballta R., Beqiraj G. 1978 — Eksperimentimi i holografisë me metodën gjeofizike të radiovalëve me ndihmën e makinës llogaritëse elektronike. Bul. Shk. Nat. Nr. 4.
4. Bezhani V., Çakalli P., Avxhiu R., etj. 1981 — Studim mbi prognozën bakërmbajtëse të efuzivëve të Mirditës Qëndrore.
5. Frashëri A. 1987 — Studimi i përhapjes së fushës elektrike në mjedise gjeologjike heterogjene dhe efektiviteti i elektrometrisë detare në studimin e strukturës Durrës-Kepi i Pallës. Disertacion.
6. Langora Ll., Bektashi Y., Alikaj P. 1984 — Studimi i përhapjes së fushës elektrike natyrore në hapësirë, drejtim i rëndësishëm për kërkim-zbulimin e trupave sulfurorë bakërmbajtës. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 2.
7. Langora Ll., Alikaj P., Gjevrecku Dh. 1989 — Achievements in the copper sulphide exploration in Albania with IP and FM methods. Geophysical Prospecting Nr. 37.
8. Lubonja L., Frashëri A., Avxhiu R., Duka B., Alikaj P., Bushati S. 1986. — Mbi rrugët për rritjen e thellësisë së kërkimeve gjeofizike.
9. Gjevrecku Dh. 1986 — Studim nëntokësor dhe sipërfaqësor i shpërndarjes së fushave elektromagnetike si një nga drejtimet e kërkimit të trupave xeherorë të pasur të sulfureve të bakrit dhe të disa llojeve kromitësh. Disertacion.
10. Naska K., Çani I., Mata S., etj. 1988 — Mbi punimet eksperimentale të polarizimit të provokuar në shpim.

SOME DIRECTIONS ON THE PREFECTION OF THE COMPLEX ELECTROMETRIC METHODS FOR THE PROSPECTION OF COPPER SULPHIDE ORES

This paper provides the results of the investigations on the prefecion of the complex electrometric methods used for the prospection of copper deposits.

The spectral analysis of the information of the induced polarization gives the data helping to judge on the sulphide ore structure of mineralized bodies and zones. By the laboratoric determination and field observations has been verified that the

ore of the massive — veiny structure has 10-100 sec. τ time parameter of extinction of the induced polarization effect, whereas in the disseminated ore it is 0,01-1 sec.

This paper gives also the results of the underground observations of the induced polarization to grow the depth of the electrometric investigations. Two way have been experimented for this purpose. The first consists to the measurement of the induced polarization throughout the borehole trunk by three electrode scheme with A 40 M 40 N, B \rightarrow ∞ maximum length, to try to find the ore bodies set laterally the borehole trunk in a (1-1,5) AM distance.

During the second way, into the borehole is inserted one of the feeder electrodes, whereas the observation of the induced polarization is made on the earth's surface. The distribution of electric field of the underground induced polarization by a mathematical modelling using terminal elements method has been studied to reach success by this observations and for their righteous interpretation.

Some algorithms and a packet of the programmes in FORTRAN-77 and BASIC languages have been compiled to realize the mathematical modelling.

PREMISAT GJEOLGJIKE TË KËRKIMIT TË METALEVE TË RRALLA TË VENDIT TONË

Kadri Gjata I.S.P. të Gjeologjisë;
Qamile Aliaj N. Gjeol. Tiranë;
Osman Lika N. Gjeofizike;
Pranvera Laze N. Gjeofizike;
Vasil Nasi N. Gjeofizike;
Riza Bega N. Gjeofizike;
Fredi Balli N. Gjeol. Korçë.

H Y R J E

Ka disa vjet, që në vendin tonë po kryhen studime tematike dhe punime komplekse për metalet e rrallë. Si rezultat i këtyre punimeve, janë saktësuar drejtimet kryesore të kërkimit dhe janë në sqarim e sipër kushtet gjeologjike të përhapjes së komplekseve magmatikë me premisa të favorshme për metale të rrallë, karakteri i zhvillimit të mineralizimeve në sipërfaqe e thellësi, veçoritë mineralogjike etj. Po bëhen përpjekje për përpunim-pasurimin dhe rikuperimin e metaleve të rrallë.

Në grupin e metaleve të rrallë përfshihen elementët e tokave të rralla (gjithsej 17 elementë), si dhe Nb, Ta, Zr, Rb, Th etj. Studimet e kryera në vendin tonë, kanë vënë në dukje se në Albanide ekzistojnë gjithashtu kushte gjeologjike për kërkimin e metaleve të rrallë (Gjata K. etj. 1986, 1989 etj.).

Premisat gjeologjike

I. Premisa të favorshme për përqëndrimin e mineralizimeve të metaleve të rrallë, shfaqen në stadin e riftëzimit kontinental jurasik, i cili i ka paraprirë zgjerimit oqeanik Mirditor. Ky stad, i zhvillimit gjeotektonik të Albanideve, shprehet me formimin e serisë vullkanogjeno-sedimentare jurasike të zonës Mirdita. Në pjesën e poshtme të kësaj serie gjen përhapje kompleksi i shkëmbinjve mesatarë e acidë subbalkalinorë, që sinjalizon etapën fillestare të riftëzimit jurasik. Pikërisht me këtë kompleks lidhen mineralizime mjaft interesante të metaleve të rrallë. Në vijim, ky vullkanizëm merr karakter bazik. Magmatizmi riftor në Albanide shënon praktikisht preludin e zgjerimit oqeanik, me formimin e ofioliteve (Kodra A. 1987, 1988, Kodra A., Gjata K. etj. 1989).

kontinentale, meritojnë vëmëndje masivi granitik i Levrushkut, me fenomene grejzenizimi etj., Arsti, Gashi, Peladhia, Sebishti etj. Nga punimet e sondazhit, në masivë të ndryshëm evidentohen vlera interesante të REE, Zr, Sr, Rb etj.

Vlerësimi metalogjenik i magmatizmit acid të vendit tonë për metale të rrallë përbën një drejtim kërkimor për të ardhmen.

IV- Me interes është gjithashtu vlerësimi i mëtejshëm dhe kompleks i shkrifërimeve të vjetra dhe të reja në vendin tonë, ku siç dihet, në disa prej tyre me përhapje të monacitit, vihen re përqëndrime të metaleve të rrallë (Sinoimeri Z. etj. 1967). Në vlerësimin kompleks të shkëmbinjve është e nevojshme të merret parasysh prania e metaleve të rrallë, për të rritur më tej vlerën shumëelementëshe të shkrifërimeve të vendit tonë.

Në shkrifërimet e vjetra të krahinës së Korçës (Mullaj F. 1970, Balli F. etj. 1987), fraksioni i dobishëm i shkrifërimeve përfaqësohet nga zirkoni, sfeni, spatiti, rutili dhe më pak monaciti. Në krahasim me objektet e tjera të vendit tonë, përmbajtja e koncentratit është më e ulët. Megjithatë tërheq vëmëndjen dhe rrit interesin për këto shkrifërime prania e ngritur e metaleve të rrallë në mineralet e koncentratit. Kështu, praktikisht mund të thuhet se në sfen fiksohen 2,2 deri 3,2% REE, në zirkon 0,57% REE në monacit deri 30,65% Ce_2O_3 , 16,27% La_2O_3 etj.

Kërkimi i mineralizimeve të metaleve të rrallë tashmë profilizohet më tej si një drejtim kërkimor në vendin tonë. Krahas zhvillimit të mëtejshëm të studimeve tematike dhe komplekse, rëndësi të posaçme kanë studimet teknologjike, të cilat në fund të fundit përcaktojnë konkretizimin e objekteve.

L I T E R A T U R A

1. Balli F., Jani P., Bega R. etj. (1987) — Projekt i punimeve gjeologjike të kërkim-zbulimit në vendburimin e shkrifërimeve Vranisht.
2. Çobo X., Vllaho J., Kasapi S. (1985) — Ndërtimi gjeologjik dhe mineralet e dobishme të rajonit Sukaxhi-Kaçinar-Kushnen.
3. Gjata K., Kodra A., Mustafa F., Zhukri E., Aliaj Q., Lika O. (1986) — Studim tematik dhe punime kërkimi për sqarimin e perspektivës për mineralet të rrallë në vendin tonë.
4. Gjata K., Kodra A., Mustafa F., Zhukri E., Aliaj Q., Huta B. (1987). — Dëshmi të miocenit të mesëm në Albanidet e brendshme dhe disa rrjedhime gjeotektonike. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 1.
5. Gjata K., Mustafa F., Lika O., Aliaj Q., Nasi V., Kasapi P., Kospiri A., Laze P. (1989) — Studim tematik dhe punime kërkimi kompleks në Mirditën perëndimore dhe Gash për mineralet të rrallë.
6. Kodra A. (1987) — Skema e zhvillimit paleogeografik e gjeotektonik të Albanideve të brendshme gjatë triasikut e jurasikut. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 4.
7. Kodra A. (1988) — Riftëzimi i kores kontinentale Mirditore dhe fazat e para të zgjerimit oqeanik gjatë jurasikut. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 4.
8. Kodra A., Gjata K., Jahja B., Godroli M. (1989) — The rifting of continental crust and the early magmatism which has preceded the Mirdita oceanic spreading. CBGA 14th Congress — Sofia.
9. Mullaj F. (1970) — Mbi zirkonin e sedimenteve të shkrifta lumore të pellgut të Devollit. Bul. USHT, ser. Shk. Nat. Nr. 1.

10. *Shallo M. (1977)* — Monconit-sienitet e rajonit të Shistavecit (zona tektonike e Korabit). Përmb. Stud. Nr. 1.
11. *Sinoimeri Z. etj. (1967)* — *Shkrifërimet bregdetare të Adriatikut*. Tiranë
12. *Tërshana A. (1932)* — Petrologjia dhe metalogjenia e kompleksit gabroperidotit të rajonit Kashnjet-Qerret. Disertacion.
13. *Bjorlykke A., Ihlen P.M. (1989)* — Metalogeny of the Oslo paleorift. Terra abstracts, v. 1, Nb 1, EUG5.
14. *Cathelinau M., Ngyen C (1986)* — Mobilite hidrotermale de U, Th et des terres rares: le role primordial des solutions phosphates. 11 RST, Clermont — Ferrand, SGF.
15. *Menzies M. (1987)* — Alkaline rocks and their inclusions: a window on the Earth's interior. Alkaline Igneous Rocks. Eilton J., Upton B. (eds). Geol. Soc. Sp. Pub. Nr. 30, 15-27.
16. *Vijayan S., Malnyk A.I. etj. (1989)* — Rare earths: their mining processing and growing industrial usage. Min. Eng. Jan. 13.
17. *Wambeke V.L. (1978)* — The Karonge Rare Earth Deposits: New Mineralogical — geochemical Data and Origin of the Mineralization. Min. Dep., 3.
18. *Wedepohl KH. (ed). (1978)* — Handbook of geochemistry. Vol. II/1, vol. II/2. Springer — Verlag, Berlin — Heidelberg — New York.

GEOLOGICAL PREMISES FOR THE PROSPECTION OF RARE METALS IN ALBANIA

The existence of the geological conditions for the prospection of rare metals (REE, Nb, etc.) has been pointed out by the thematic and complex investigations carried out in our country.

I- The Jurassic continental rifting, which has preceded Mirdita's oceanic spreading shows favourable premises for the concentration of these mineralizations. This stage is characterized by the formation of the Jurassic volcano-sedimentary serie of the Mirdita zone, at the lower part of which widespread is a subalkaline intermediate-acid complex. Precisely with this complex are linked rare metal mineralizations. The manifestations of this magmatism appear in the form of flows, dykes, stocks etc., often of considerable dimensions. This subalkaline complex is composed of trachytriolites, trachytriodacites, brachytes etc. Their main constituents are plagioclase and orthoclase placed in a vitrophyric mass. The biotite and quartz occur rarely. An interesting moment is the presence of some mantle xenocrysts such as pyrope, spinel, corundum etc.

Rare earth data plotted on the chondrite-normalized diagram show the enrichment in LREE and flat HREE distribution. Especially remarkable is the negative anomaly of europium, which is linked with the plagioclase effect. The mineralizations of rare metals (REE, Nb, Ta, Zr, Rb, etc.) are concentrated in trachytes and hydrothermally transformed aphyric trachytriolites (albitized, quartzitized, chloritized, etc.), in the form of wide zones of linear extension. The main REE, Nb, Ta, etc. concentrations are linked with the accessory minerals of magmatic stage such as REE-bearing ilmenite, Nb-Ta-bearing ilmenorutile, a rich-cerium-bearing iron-titanium mineral, monazite and apatite. In the later pneumatolytic-hydrothermal stages appear mineral associations with interest for REE concentrations such as cerium-bearing leucogene, fluorocerite, fluorite etc. In these stages occurred possibly REE, Th, etc. mobilization and the main role played the carbonate-phosphate-fluorite solutions.

II- REE mineralizations situated within the ophiolitic environment, at the interval of development of gabbro amphibolite complex with titanomagnetite and apatite, are of the most interest. This complex occupies lower part of the basic effusive serie. It is possible that in the concentration of these mineralizations has played a role the oceanic hydrothermalism (interaction of contemporaneous seawater with hot mafic rock) affecting the amphibolites etc. with Fe-Ti and apatite, leading to the REE re-mobilization and concentration.

III- The Paleozoic and Mesozoic basic to acid intrusive-effusive magmatic complexes linked with the continental crust fracturings and the Triassic-Jurassic rifting stages in Albanides, snow favourable premises for rare metal mineralizations. The monzonites with abundant accessory mineralization, especially with Be, ignimbrites, orthophyres, granitic massifs, must be taken into consideration. In some of them are developed greisenization phenomena and are fixed interesting contents of REE, Zr, Sr, Rb, etc.

IV- The further evaluation merit placer deposits. In some ancient placer deposits occur monacite, sphene, rutile etc. with high REE contents.

The prospection of rare metal mineralizations is a new research direction in our country. The specialized geological, mineralogical-geochemical and technological investigations should be carried out in the future.

TEKTONIKA TËRTHORE NË ALBANIDE DHE MINERALIZIMET E REJA TË LOKALIZUARA NË TË

Andon Grazhdani Fak. Gjeol. Min.,
Shyqyri Aliaj Qendra Sizmologjike,
Hadi Tuzi N.Gj. Shkodër;
Tonin Dedda N.Gj. Pukë;
Vesël Hoxha N.Gj. Bulqizë

H Y R J E

Studimet e reja kanë vënë në dukje rolin e tektonikës tërthore në Albanide, si në evolucionin e strukturës së lashtë e të re, ashtu edhe në metalogjeninë e në aktivitetin sizmik (Tektonika e Albanideve, 1985; E. Sulstarova, 1986, A. Grazhdani, 1987; Sh. Aliaj, 1988 etj.).

Në këtë kumtesë, bazuar në shkallën e sotme të njohjes, trajtohen tektonika tërthore në Albanide, mineralizimet e reja të lokalizuara në këto tërthore, magmatizmi i ri terciar, rreth vendit tonë dhe lidhja e mineralizimeve të reja me hidrotermat e magmatizmit terciar. Së fundi jepen përfundime për faktorin strukturor e atë litologjik të lokalizimit të mineralizimeve të reja, që mund të shërbejnë si kritere kërkimi për të ardhmen.

1. Tektonika tërthore në Albanide

Tektonika tërthore në Albanide ka luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin e strukturës gjeologjike të lashtë e të re, në metalogjeninë dhe në aktivitetin sizmik. Ajo është krijuar njëkohësisht me tektonikën gjatësore, qysh kur hedhin themelet zonat tektonike në paleogjeografinë e lashtë mesozoike dhe është trashëguar nga njëra etapë në tjetrën. Tërthoret kryesore vijnë aktive deri në ditët tona (Sh. Aliaj, 1988; E. Sulstarova, 1986).

Tërthorja Shkodër-Pejë (fig. 1). — Ka shtrirje VVL dhe ndan Albanidet në dy pjesë, ku vijueshmëria e zonave tektonike është e ndryshme. Ajo është vendosur qysh me riftimin kontinental liasik në jurasik të mesëm-të sipërm, kur u hap baseni oqeanik i Mirditës, ka funksionuar si shkëputje transformuese; gjatë periudhave orogjenike jurasike e sipërme — kretake e poshtme dhe terciare ka funksionuar si shtytje e djathtë, duke bërë zhvendosjen drejt perëndimit në distanca të mëdha të zonës ofiolitike të Mirditës, në jug të saj. Në etapën neotektonike, gjatë plio-

lokalizuar në trevën e brendshme me strukturë horst-grabenore, gjatë ose pranë zonave të shkëputjeve tektonike të reja, aty ku kushtet litologjike kanë favorizuar depozitimet e tyre.

Gjatë e pranë zonës së tërthores Shkodër-Pejë dallohen dy breza mineralizimesh. Brezi i mineralizimeve të Hg, As, F, Pb, Zn e Ba vendoset në depozitimet e nënzonës së Cukalit e në kufirin verior të zonës së Mirditës. Brezi i mineralizimeve të asbestit e magnezitit vendoset në shkëmbinjtë ultrabazikë të anës veriore të zonës së Mirditës. Të dy brezat vendosen gjatë e pranë tërthores Shkodër-Pejë.

Si rregull, mineralizimet e asbestit, talkut e magneziteve lidhen me kumulatet ultrabazike pranë shkëputjeve të reja tektonike.

Mineralizimet polisulfure e polimetalike vendosen në nyjet e ndërprerjes të shkëputjeve të reja tërthore me ato gjatësore.

L I T E R A T U R A

1. *Aliaj Sh.* 1988 — Neotektonika dhe sizmotektonika e Shqipërisë. Disertacion për gradën «Doktor i Shkencave».
2. *Arsovski M., Ivanov T.*, 1977 — Neotectonics, Magmatisme and Metallogeny on the territory of Yugoslavia.
3. *Duro A., Duka V., Nikolla M.* — Fluorit në shkëmbinjtë karbonatikë. Bul. Shk. Gjeol. 2.
4. *Grazhdani A.* 1981 — Perspektiva e kërkimit të mineralizimit të zhivës në të dy anët e thyerjes Shkodër-Tropojë. Disertacion.
5. *Grazhdani A.*, 1987 — Metalogjenia e thyerjeve tërthore të Albanideve. Bul. Shk. Gjeol., 4.
6. *Gjata K., Kodra A.*, 1982 — Magmatizmi pasofiolitik jurasiko-kretak dhe al më i ri mesataro-acid në vendin tonë. Bul. Shk. Gjeol., 4.
7. *Liko V.*, 1975 — Përbërja kimike, tipi i mineralit dhe veçoritë fizike-mekanike të asbestit në shfaqjet e mineralizuara të rajonit të Gomsiqes. Përmb. Stud. Nr. 3.
8. *Ndojaj I., Poga K.*, 1969 — Problemi i asbestit të Pukës. Përmb. Stud. Nr. 2.
9. *Ndojaj I., Bakalli F., Gjata K.* 1972 — Mendime për mineralizimet polimetalore të vendit tonë Përmb. Stud. Nr. 4.
10. *Osmani N., Mullaj F.*, 1975 — Disa të dhëna mbi mineralet shoqërues të zonave asbestmbajtëse të vendit tonë. Përmb. Stud. Nr. 2.
11. *Premti I.*, 1971 — Disa veçori të lokalizimit të arsenikut në rrethin e Dibrës. Përmb. Stud. Nr. 1.
12. *Sinoimeri Z., Ostrosi B., Grazhdani A. etj.* 1978 — Të dhëna paraprake mbi tipet e mineralizimit të zhivës në një rajon të pjesës veriore të zonës së Mirditës. Përmb. Stud. Nr. 2.
13. *Sinoimeri Z., Buda V., Turku A. etj.* 1981 — Studim përgjithësues mbi disa tipe të mineralizimit polisulfur në vendin tonë.
14. *Sorel, D.*, 1989 — L'évolution structurale de la Grèce Nordoccidentale depuis le Miocène, dans le cadre géodynamique de l'arc égéen. Thèse de Docteur es Sciences, Orsay.
15. *Sulstarova E.*, 1986 — Mekanizmi i vatrave të tërmeteve dhe fusha e sforcimeve tektonike të sotme në Shqipëri. Disertacion.

16. *Shallo, M.* 1970 — Mbi problemin e magmatizmit acid në Shqipëri. Bul. UT, ser. shk. nat., 4.
17. *Shkodrani N.*, 1973 — Aspekte të talkut e gurtalkut në zonën e Mirditës. Përmb. Stud. Nr. 2.
18. *Shkodrani N.*, 1981 — Kushtet e formimit të asbestit e të talkut, ligjësitë e për-bërjes dhe perspektiva e tyre në vendin tonë. Disertacion.
19. *Tërshana A.*, 1982 — Petrologjia dhe metalogjenia e kompleksit gabro-peridotit në rajonin Kashnjet-Qelzë. Disertacion.
20. *Theodhori P., Bushati, Sh. Pirderi, A.*, 1978 — Stratigrafia e depozitimeve mesozoike të zonës së Cukalit dhe disa probleme të mineralmbajtjes.
21. *Vaso P.* 1977 — Mbi mineralizimin e dausonitit të rajonit të Komanit. Përmb. Stud. Nr. 2.
22. — Tektonika e Albanideve. I.S.P. të Gjeologjisë Tiranë, 1985.

TRANSVERSAL FAULTS AND NEW MINERALIZATIONS LOCALIZED IN THEM

The recent investigations have pointed out the role of transversal faults in the geological evolution, metallogeny and seismic activity. The following three main transversals which intersect the structure of Albanides and follow in NE out of our state border are now known: Shkodër-Pejë, Lushnje-Elbasan-Dibër and Vlorë-Tepelenë-Korçë.

The transversal faults have been created simultaneously with the longitudinal ones when the tectonic zones have been founded; they are inherited from one development stage to another and the main transversals come active to our days (fig. 1). Mineralizations and the aureolas of realgar-auripigmentum, cinnabarite, fluorite, barite, polymetallic and polysulphide mineralizations, asbestous, talc and magnesite are characteristic of these transversals (fig. 2).

The important ore deposits and mineralizations are known in NE continuation of these transversals in Yugoslavia (fig. 3).

Two mineralization bands are developed along or near the Shkodër-Pejë transversal. The mineralization band of Hg, As, F, Pb, Zn and Ba is situated in the sediments of the Cukali subzone and in northern border of the Mirdita zone. The asbestous and magnesite mineralization band is localized in the ultrabasic rocks of the northern part of the Mirdita zone; the asbestous, talc and magnesite mineralizations are linked with the ultrabasic cumulates near new faults. The polysulphide and polymetallic mineralizations occur in the knots of the intersections of these new faults.

Two following belts of the Tertiary magmatism of different nature can be distinguished in Dinarides-Albanides-Hellenides up to Taurides folded belt.

1- Cyclades Plio-Quaternary volcanic arc with the calc-alkaline serie, similar to the island arc one;

2- Oligo-Miocene magmatic belt with the potassic calc-alkaline serie situated widely after the Cyclades volcanic arc and in the form of a relatively narrow belt from Greece-Yugoslavia border in NNW. The latter reaches to Pliocene and is of the same nature.

The subduction of the mantle lithosphere of the Adriatic plate (outer zones of Albanides) detached from crust and sedimentary cover is associated with K-rich calc-alkaline magmatism (fig. 5).

The Tertiary magmatism is not yet verified in our country, but its influence has been evidenced in outer-zones (the potassic tuffites of Gramshi in the Oligocene-Aquitania deposits, the tuffs of Cakrani in Burdigalian deposits). The new mineralizations occurred in our country are linked with the new Tertiary magmatism. The mineralizations are epigenetic, intersect the entire rocky sequence and are controlled by new fault activity. They occur everywhere along or near new faults with normal component, which have affected the ancient structure in inner zones with the extensional regimen.

It is supposed that the hydrothermal solutions rich in these elements come from the east of our country, where the Tertiary magmatism occurs.

The localization of mineralizations in the zones of new faults (mainly transverse) serves as a prospection criterion.

PELLGJET QYMYRORE DHE PERSPEKTIVA E TYRE

Llazar Dimo Kryeministri;
 Pandeli Pashko I.S.P. të Gjeologjisë
 Polikron Vaso I.S.P. të Gjeologjisë;
 Petrika Kita N.Gj. Korçë;
 Nuna Çili N.Gj. Tiranë;
 Pirro Bibaja N.Gj. Tiranë;
 Arqile Palko N.Gj. Korçë;
 Jani Adhami N.Gj. Pogradec.

H Y R J E

Qymyrbajtja e vendit tonë lidhet me depozitimet molasike të ultësirave të mbivendosura mbi zonat e brendshme dhe ato të jashtme. Në bazë të punimeve për kërkim-zbulimin e qymyreve (Bendo Dh. etj. 1979) dhe studimeve stratigrafike, paleogjeografike-gjeotektonike (Dimo Ll. etj. 1980, Dima Ll. etj. 1981 etj.) janë përcaktuar pellgjet qymyrore dhe brenda tyre formacionet përbërëse, qymyrbajtja, perspektiva dhe moshë e tyre. Formacionet qymyrbajtëse janë formuar gjatë fazave të vonshme të zhvillimit të Albanideve dhe migrimi i tyre në kohë e hapësirë ka ecur nga territori i zonave të brendshme në ato të jashtme, duke krijuar pellgje me moshë e veçori të vetat. Dallohen pellgje qymyrorë të oligocen-miocenit të poshtëm, të tortonianit dhe të pliocenit (fig. 1).

Pellgjet qymyrore të oligocenit — miocenit të poshtëm

Bëjnë pjesë në Ultësirën e Korçës ose hullinë Shqiptare-Thesaliane. Qymyrbajtja e tyre lidhet me depozitimet e ciklit të dytë molasik, me moshë oligocen-miocen. Brenda këtij cikli molasik janë ndarë tre formacione qymyrbajtëse të formuar në kushte lagunore, brenda pellgut detar që mbushte këtë hulli ndërmaalore të mbivendosur në zonën e Mirditës. Përhapja e tyre brenda hullisë ndjek drejtimin e zhvillimit të transgresionit detar nga juglindja në veriperëndim (fig. 2).

Formacioni qymyrbajtës i Drenovës vendoset mbi konglomeratet bazale të Mborjes dhe mbulohet dora-dorës nga formacioni koralor i Dre-nicës që përfaqëson vendosjen e rregjimit detar dhe zhvillimin maksimal të transgresionit të tij, në të gjithë pellgun e hullisë. Ai përmban

L I T E R A T U R A

1. Bendo Dh., Bibaja P., Murati H., etj. 1986 — Raport gjeologo-gjeofizik për kërkim-zbulimin e qymyreve në sektorët Kamëz-Babru-Arameras të vendburimit Tiranë.
2. Bendo Dh., Onuzi K. 1968 — Qymyrbajtja e depozitimeve të Miocentit të sipërm në zonën Tiranë-Rinas dhe orientimet e punimeve të mëtejshme të kërkimit. Kumesë.
3. Bibaja P., Shkupi D. 1973 — Mbi bashkësinë e komplekseve qymyrbajtëse miocenike e plio-kuaternare të vendit tonë. Përmb. Stud. Nr. 3, Tiranë, 1973.
4. Dimo Ll. 1989 — Kushtet e formimit, shkalla e qymyrezimit të qymyreve të RPS të Shqipërisë dhe perspektiva e tyre. Disertacion.
5. Dimo Ll., Pine V., Pashko P. etj. 1980 — Studim tematik-përgjithësues për përcaktimin e prognozës qymyrbajtëse të strukturës Gorë-Mokër.
6. Dimo Ll., Bendo Dh., Pashko P. etj. 1981 — Studim tematiko-përgjithësues për përcaktimin e prognozës qymyrbajtëse të strukturës së Tiranës.
7. Kita P., Dhimitri T. 1979 — Relacion për punimet e zbulimit dhe llogaritjen e rezervave me gjëndje 31.12.1979 në pjesën lindore të fushës II dhe III të vendburimit Mborje-Drenovë.
8. Pashko P. — 1967 — Mbi depozitimet neogjenike të Gropës së Burrelit. Bul. USHT, ser. Sh. Nat. Nr. 3.
9. Pashko P. 1973 — Kushtet e formimit të depozitimeve tortoniane në ulësitat e Tiranës e Pranëadriatike lidhur me qymyrbajtjen e tyre. Nafta dhe Gazi, Nr. 5.
10. Shkupi D. 1983 — Gjeologjia dhe qymyrbajtja e sinklinalit të Mokrës. Disertacion.

COAL-BEARING BASINS OF ALBANIA AND THEIR PERSPECTIVE

Coal-bearing basins of our country have been mainly formed during the late stages of the geotectonic development of Albanides migrating in time from the Albanian-Thesalian basin overlying the Mirdita zone to the Tirana and Pre-Adriatic depressions overlying the outer zones. The coal-bearing formations of the Oligocene-Lower Miocene and Tortonian coastal lagoonal facies (paralic type) and the marshy-lake facies (limnic type) of Pliocene as well as the Tortonian formations of Burreli are distinguished within these basins.

The Oligocene-Lower Miocene coal-bearing formations spread only within the Albanian-Thesalian basin distinguish by a coal-bearing migration from southeast to northwest and towards the centre of the sedimentary basin. The Tortonian coal-bearing ones are spread on this basin and mainly in the Pre-Adriatic and Tirana depressions migrating together with their coal strata from southeast to northwest and towards the centre of the basin (the Formation of Mëzezi).

The Pliocene coal-bearing formations have been mainly formed in the restricted continental water basins filling graben holes formed on the continually rising continent. They distinguish by the obvious facial changes depending on the size, position and characteristics of the basin and the surrounding continent.

The Oligocene-Lower Miocene and Tortonian coal basins in the continuation of coal-bearing formations out of the outlines of the known and investigated coal-bearing sectors are of a greater perspective.

KLASIFIKIMI INDUSTRIALO-MORFOLOGJIK I LËNDËVE BITUMINOZE TË VENDIT TONË

Polikron Vaso I.S.P. të Gjeologjisë
Simon Duni N.Gj. Gjirokastrër

H Y R J E

Në vendin tonë janë të pranishme disa lloje lëndësh bituminoze, të cilat sipas kohës, mënyrës së formimit, kushteve të ndodhjes, përbërjes litologjike, teksturave e strukturave të shkëmbinjve lokalizues si dhe të përbërjes grupore të vetë naftave kanë karakteristika cilësore, morfologji e përmasa të ndryshme (Vaso P. etj. 1989).

Në literaturën botërore, për lëndët bituminoze ka emertime e klasifikime të ndryshme sipas qëllimit të studimit gjeokimik analitik apo teknik (industrial) si dhe sipas mënyrave e metodave që përdoren për studimin e këtyre lëndëve: kimik, (Uspenski etj. 1974) fizik apo petrografik (Jacob, 1967, Alpern, 1970). Emërtimet e tyre në shumicën e rasteve janë lokale dhe nuk kanë mundur të kodohen ashtu siç janë koduar qymyret dhe linjitet (Lexique int. 1963, 1975). Të tillë mund të përmendim atë të Hunt etj. (1984), ku gjithë lëndët bituminoze ndahen në bitume (të tretshme në Tetraklorur karboni) dhe në pirobitume (të patretshme e të pa shkrirshme, fig. 1).

Metodika e punës

Metodika e punës për studimin e lëndëve bituminoze të takuara në vendin tonë ka qenë kombinimi i përcaktimeve fiziko-kimike (tretshmëria në tretësa organike, pika e zbutjes, analiza grupore, teknike, difraktometrike etj.) me ato mikroskopike (studimi me dritë të reflektuar, të polarizuar, me fluoreshencë), si dhe vrojtimit fushor makroskopike (ndërtimi tekstural, morfologjia e përmasat e përqendrimeve bituminoze, marrëdhëniet strukturore me shkëmbinj të lokalizues). Për njohjen e këtyre karakteristikave dhe të vendpërhapjes së tyre janë studiuar edhe raportet gjeologjike (Çako 1983, Duka 1980, Hajnaj 1978, Kamberi 1981 etj.).

Nisur nga karakteristikat cilësore, morfologjike e nga përbërja litologjike e përqendrimeve bituminoze dhe pozicioni struktural i tyre, duke u bazuar edhe në fushat e përdorimit të tyre (aspekti teknik) përpiluar

të shpeshta të kontinentit, të cilat bëjnë që të kemi luhatje të shpeshta të cilësisë e morfologjisë së tyre.

10 — *Antraksolitet (kataimpsonitet)* — Janë takuar shenja të pakta në Përroin e sqfurit pranë vendburimit të Selenicës. Karakterizohen nga një mostretshmëri e plotë në tretësa organikë. Lëndët flurore janë të ulta 20.69% (në masën e thatë pa hi), aftësia reflektuese 2.74%; ka pamjen e një koksi.

Përfundime

1- Në vendin tonë janë të pranishme këto lloje lëndësh bituminoze me rëndësi industriale:

— Bitumitet (pirobitumet), 2- rërat vajoro-rëshinore,-ranorët-asfaltikë e asfaltiko-rëshinorë që njihen me emrin ranorët bituminozë; 3- asfaltet, asfaltitet. Janë takuar gjithashtu shenja të vogla të antraksoliteve dhe të ozokeriteve (dyllrave mineralë) por ato janë me rëndësi mineralogjike.

2- Rëndësia e kërkimit dhe studimeve të mëtejshme gjeologjike e sidomos teknologjike është e domosdoshme për vetë faktin se janë lëndë deficietare në botë dhe kanë përdorim në disa degë.

LITERATURA

- 1- Çako J., Papa Dh., 1983 — Raport gjeologjik i vendburimit Skërkallave Selenicë.
- 2- Diamanti F., Dhimulla I., 1982 — Gjurmët e mërgimit të fluideve bituminoze në prerjen karbonatike të zonës Jonike. Nafta dhe Gazi, nr. 2.
- 3- Duka A., 1980 — Raport mbi punimet e kërkim-zbulimit në vendburimin e rërave bituminoze të Treblovës.
- 4- Hajnaj L. etj., 1978 — Raport mbi punimet e zbulimit të vendburimit të rërave bituminoze Patos, Kasnicë.
- 5- Kamberi L., 1981 — Referat në sesionin shkencor të Fakultetit Gjeologji-Miniera.
- 6- Myftari R., Pleqi I., 1964 — Raport gjeologjik për bitumin, zhavorin dhe ranorin bituminoz në vendburimin e Selenicës.
- 7- Pritfi Dh., Çuri F. etj., 1985 — Vlerësimi i potencialit naftë-gazformues të depozitimeve të Tortonianit në brezin lindor të Ultësirës Pranadriatike.
- 8- Vaso P., Ylli M. etj., 1986 — Studim për sqarimin e perspektivës së bitumiteve të qymyrëzuar dhe zgjedhja e rrjetit të zbulimit në vendburimin e Selenicës.
- 9- Vaso P., Duni S., 1989 — Studim tematik për zgjerimin e perspektivës për bitumite dhe ranorë bituminozë në rajonet Selenicë, Patos dhe Q. Stalin-Murriz.
- 10- Alpern B., 1970 — Classification petrographique des constituants organiques fossiles des roches sedimentaires.
- 11- Jacob H., 1967 — Petrologie Won Asphaltiten und asphaltischen, Pyrobitumina. Erdot u Kohle — 20. Jahrgaug nr. 6.
- 12- John M. etj. — Bituminous materiales.
- 13- Lexique international de petrographie des charbons. Viti 1963, 1975.

14- Uspenski A.V., 1974 — Osnovi geneticheskoj klassifikacii bitumov.

INDUSTRIAL-MORPHOGENETIC CLASSIFICATION OF THE BITUMINOUS SUBSTANCES OF OUR COUNTRY

This paper provides the grouping of the bituminous substances of our country from the technical aspect, according to the qualitative and morphologic characteristics and fields of their employment.

This classification has been made possible owing to the combination of the physical-chemical with the petrographical determinations carried out in the outcrops, objects and bituminous deposits.

The carried out investigations revealed that in our country there exist some sorts of the bituminous substance having qualitative, morphologic features and different dimensions, depending to the time and the model and conditions of their concentration, lithological, textural and structural composition of rocks in which they are localized, as well as on the chemical contents of the oils themselves (as their source).

In some places, the bituminous substance can be accumulated in the sedimentary basins being deposited together with the sediments where is situated such as the bitumites (Pyrobitumens), or so-called bituminous gravels of Selenica. But, the oil has been penetrated in rocks after their petrification filling the pores and holes such as oily-resinous sands, sands, asphalts and asphaltic-resinous sands, it is also penetrated through the cracks of the aleurolitic and conglomeratic limestone rocks etc. such as the veiny asphalts, asphalts and asphaltic rocks (asphaltic limestones, asphaltic argillites etc.).

The classification of the bituminous substances is based on their physical-chemical state, the degree of its solvability in organic solvents which show the intensity of the transformation of this substance from the initial moment (the processes of degradation and biodegradation of oil).

In fig. 2 is summarily given the classification of these substances. As seen, 10 sorts of the bituminous substance are recently known in our country. But, mainly the bitumites (Pyrobitumens), asphalts, asphaltites, oil-resinous sands, asphaltic and asphaltic-resinous sands are of an industrial importance.

SITUATA GJEOLGJIKE PËR XEHERORËT E HEKUR-NIKELIT Ë NIKELIT-SILIKAT DHE DETYRAT PËR TË ARDHMEN

Eshref Pumo Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave
Feti Arkaxhiu I.S.P. të Gjeologjisë
Perikli Jani N.Gj. Korçë
Stavri Burri Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave
Marie Koçi, I.S.P. të Gjeologjisë

H Y R J E

Kërkimet gjeologjike të kryera gjatë periudhës 33 vjeçare (1956-1989) kanë grumbulluar të dhëna të rëndësishme mbi praninë dhe përhapjen e xeherorëve lateritikë të nikelit-silikat dhe të hekur-nikelit në vendin tonë (fig. 1). Krahas tyre, punimet e shfrytëzimit kanë ndihmuar në saktësimin e mëtejshëm të kufijve të përhapjes së mineralizimit, në njohjen e tipeve xeherore sipas vendburimeve dhe brenda të njëjtit vendburim si dhe kanë saktësuar më tej problemet e mënyrës së formimit të tyre (Pumo E., 1981, 1986; Arkaxhiu F., 1986, 1988).

1- Përhapja e xeherorëve të hekur-nikelit dhe të nikelit-silikat në Shqipëri. Karakteristikat e tipeve xeherorë.

a — Në rajonin ndërmjet Librazhdit dhe Pogradecit, punimet gjeologo--zbuluese dhe ato të shfrytëzimit kanë saktësuar më tej njohjen e natyrës së trupave xeherorë, të kontaktit të shkëmbinjve të tabanit e tavanit dhe ndikimin e tektonikës shkëputëse gjatë punimeve të shfrytëzimit. Në grupin e vendburimeve të pjesës lindore, ku xeherori ndodhet ndërmjet shkëmbinjve ultrabazikë pak ose shumë të tjetëruar, në taban, dhe gëlqerorëve rudistorë të senonianit në tavan, veçohet sektori Skroskë-Prrenjas, me rezerva të rëndësishme, në të cilin mbisundon tipi pelitik krahas atij oolitik pizoklik, gjë që ka kushtëzuar dhe përmbajtjen më të lartë të hekurit e të nikelit në krahasim me vendburimin Guri i Kuq (fig. 2).

Në pjesën perëndimore të këtij rajoni (rajonit Polisit), xeherorët e tipit sedimentar, vendosen ndërmjet gëlqerorëve të kretakut të poshtëm, në taban, dhe atyre të kretakut të sipërm, në tavan. Të tillë janë vendburimet e Xhumagës dhe të Liqenit të Kuq, si dhe mineralizimet e tjera

grupi specialistësh për zgjidhjen e problemit të përbërjes lëndore të xeherorëve të hekur-nikelit dhe të nikelit-silikat të vendit tonë.

Shfrytëzimi i vendburimeve, tashmë të zbuluara dhe atyre që do të gjenden e do zbulohen në të ardhmen, duhet të jetë kompleks. E theksojmë këtë, sidomos për vendburimin e Bitinckës, ku punimet e nxjerrjes janë kufizuar vetëm në xeherorin e hekur-nikelit, duke lënë nëntokë xeherorin e nikelit-silikat.

L I T E R A T U R A

- *Arkaxhiu F. Bushi E. (1967)* — Ndërtimi gjeologjik, tektonika dhe perspektiva e përhapjes së xeherorëve të hekur-nikelit në zonën Bushtricë — Pishkash. Përm. stud. Nr. 6.
- *Arkaxhiu F. (1986)* — Kushtet e formimit të xeherorëve hekur-nikelorë të rajonit Librazhd-Pogradec dhe perspektiva e kërkimit të tyre. Disertacion.
- *Arkaxhiu F. (1988)* — Gjeologjia e xeherorëve hekur-nikelorë të vendburimeve Xhumagë dhe Liqeni i Kuq. Bul. Shk. Gj., nr. 4.
- *Arkaxhiu F. (1989)* — Një tip i ri mineralizimi i hekur-nikelit në afërsi të Librazhdit.
- *Burri S. (1984)* — Përbërja minerale e xeherorëve të hekur-nikelit dhe të nikelit silikat në vendburimin e Bitinckës në rrethin e Korçës.
- *Burri S. (1984)* — Përbërja minerale e xeherorëve të hekur-nikelit në rajonin e Pogradecit.
- *Burri S., Pine V., Jani P. (1988)* — Tipet dhe prerjet e koreve lateritike të xeherorëve të hekur-nikelit dhe të nikelit-silikat në Shqipëri. Bul. Shk. Gjeol., nr. 2.
- *Dilo T. (1989)* — Studim paraprak i mineraleve laterite të disa vendburimeve tona. Bul. i Shk. Nat., nr. 1.
- *Harta Metalogjenike e Shqipërisë (1989)*.
- *Hido M., Bello A., Merolli A. etj., (1987)* — Studimi teknologjik për rritjen e cilësisë së koncentratit të hekur-nikelit në fabrikën e pasurimit «Guri i Kuq».
- *Jani P. (1989)* — Raport me llogaritjen e rezervave të vendburimit Bitinckë. *Koçi M., Arkaxhiu F., Thanasi A., Dilo T. (1989)* — Përbërja mineralogjike e fazore e hekurit dhe e nikelit në xeherorët e hekur-nikelit të rajonit Librazhd-Pogradec.
- *Pumo E. (1981)* — Formimet e kores së lashtë të tjetërimit në Albanidet vendlindore. Përmb. Stud., nr. 1.
- *Pumo E. (1986)* — Lateritet, mineralet e dobishme që lidhen me të. Monografi.
- *Pumo E., Arkaxhiu F., Burri S., Jani P., Molla I. (1986)* — Xeherorët e hekur-nikelit dhe të nikelit silikat në vendin tonë. Perspektiva dhe drejtimet e kërkimit të xeherorëve të pasur. Referat.
- *Pumo E. (1988)* — Ecuria e prodhimit, importit dhe eksportit të mineraleve të dobishme në botë në vitet 80-të dhe disa detyra për vendin tonë. Informacioni shkencor.

GEOLOGICAL SITUATION OF THE Fe-Ni AND NICKEL-SILICATE ORES AND THE TASKS FOR THE FUTURE

This paper gives the achievements in the prospection of iron-nickel and nickel silicate ores. The main types and substantial composition are treated.

Based on the importance and the recent knowledges, the following three regions can be distinguished:

- 1- Librazhd-Pogradec region with the iron-nickel ores,
- 2- Bilishti region with iron-nickel and nickel silicate ores,
- 3- Kukësi region with the nickel-silicate and iron-nickel ores.

1- In the Librazhd-Pogradec region, by the prospection and exploitation works, are drawn new data, which have further clarified the knowledges on the setting structure of the iron-nickel ores bodies and their perspective in the western and southwestern part of the Bushtrica-Skroska-Prrenjasi. The prospection works carried out in 1989 led to the prospection of a new iron-nickel ore horizon near the Hotolisht.

Three ore types can be distinguished based on the formation conditions:

a- In situ and partial removed ores, where the ore bodies occur between the ultrabasic rocks in the rock bottom and the Upper Cretaceous carbonate deposits on the top (the ore deposits of the eastern flank of the Shkumbini river, Bushtrica, Skroska, Përrenjasi, Rodokali, Çermenika, Guri i kuq etc.).

b- replaced (sedimentary) ores, situated between the Lower Cretaceous carbonate deposits in the rock bottom and, the Upper Cretaceous ones on the top (the ore deposits of the western flank of the Shkumbini river, Xhumagë, Liqeni i Kuq etc.),

c- sedimentary ores, localized between the Paleogene molasse deposits in the bottom and the Neogene ones on the top (Hotolisht).

2- In the southeast, in the Bilishti region, occur a wider ore field. The nickel-silicate and iron-nickel ores are founded in the above mentioned region. The mineralizations are of the lateritic type, localized on the serpentinized ultrabasic rocks and covered by the Eocene deposits.

3- The promising data, for iron-nickel and nickel-silicate ores are drawn from the Kukësi region, in the southern part, near the Nome and other villages. They are residual lateritic formations situated between the ultrabasic rocks in the bottom and the Lower Cretaceous carbonate deposits on the top.

New steps are made for the investigation of the substantial contents of the iron-nickel ores of the Librazhd-Pogradec region, mostly after the construction of the «Steel of the Party» Metallurgic Combine in Elbasan.

The reserves are colossal and there exist the possibilities to increase them.

It is necessary to profound the investigations for the complex processing of these ores, mainly in the Bitincka deposit, where two types of ores occur practically one above the other (nickel-silicate and iron-nickel, from bottom to top, respectively).

FOSFORITET E ZONËS JONIKE DHE RRUGËT E PASURIMIT TË TYRE

Afat Serjani I.S.P. të Gjeologjisë
Sotir Duda I.S.P. të Teknol. Minerale
Ramiz Husi N.Gj. Gjirokastër

H Y R J E

Në këtë kumtesë paraqiten shkurtazi rezultatet në kërkimin, zbulimin dhe vlerësimin e fosforiteve të zonës Jonike, të arritura me punime e studime të shumta. Jepet përhapja dhe veçoritë stratigrafike, litologjike, sedimentologjike e kimike të horizontit fosfatik të Kretakut të sipërm, me të cilin lidhen vendburimet e zbuluara dhe drejtimet e mëtejshme të kërkimit.

Pjesa e dytë i kushtohet problemit të pasurimit të rezervave të zbuluara, të cilat arrijnë sasira të mëdha. Paraqiten rrugët e ndjekura gjatë studimeve dhe eksperimentimeve, duke u ndalur më hollësisht në dy metodat më të studjuara dhe të mundëshme për zbatim: në pasurimin me lëngjet mëmë të uzinës së sodës kaustike të Vlorës dhe me solucionet e melasës. Në fund jepen epokat fosforogjenike dhe depozitimet perspektive për kërkimin e fosforiteve në zonat e tjera tektonike të vendit tonë.

I- Fosforitet e zonës tektonike Jonike

Në depozitimet karbonatike të zonës Jonike njihen dy nivele të mineralizimit fosfatik (fig. 1):

Fosforitet jurasike dhe kretake. Niveli i dytë është më kryesori si nga përhapja edhe nga rëndësia praktike. Fosforitet jurasike lidhen me pushimin në sedimentim. Mineralizimet jurasike takohen në brezat antiklinalë të Kurveleshit e Çikës. Mineralizimi gjëndet në formën e dy tipeve morfologjiko — gjenetike.

1. Mineralizimi sedimentar shtresor
2. Mineralizimi i infiltracionit që mbush çarjet midis gëlqerorëve masivë të liasit të poshtëm e të mesëm.

Mineralizimi shtresor takohet rrallë. Vetëm në vendburimin 24 Maj ka parametra industriale si në trashësi dhe në përmbajtje duke arritur deri 20-25 % P_2O_5 . Mineralizimi i tipit të infiltracionit është më i përhapur në vendburimet e Bogazit, 24 Majit etj. Duke qenëse ky mine-

III- Premisat e kërkimit të fosforiteve në zonat e tjera tektonike të vendit

Krahas fosforiteve të zonës Jonike, në vendin tonë njihen disa anomalitë e shfaqje të varfëra fosfatike të lidhura me mineralizimet e hekurit manganit në zonën e Korabit, (Hoxha V., Alliu I. 1979) si dhe anomalitë të shkëputura të fosforit në zonën e Alpeve, të Cukalit, të Krujës, në Ultësirën Pranëadriatike etj.

Përveç fosforiteve të lidhura me epokën fosforogjenike të kretakut dhe jurasikut në zonën Jonike dhe mineralizimeve të silurian — devonianit në zonën e Korabit, duhet të zhvillohen kërkime edhe për epokën miocenike në Ultësirën Pranëadriatike e në gropat e brendshme, për atë permiane në zonat e Korabit e Gashit, dhe për atë Ordovikianë po në zonën e Korabit (Serjani A. 1988). Nivelet fosfatike stratigrafike të njohur duhet të kontrollohen në të gjitha strukturat e zonat tektonike. Përveç premisave stratigrafike njihen edhe një seri premisash të tjera për kërkimin e fosforiteve. Të tilla janë ato litologo-faciale e paragjenetike. Për fosforitet e moshave të vjetra janë karakteristike lidhja e tyre me faciet terrigjene si rreshpet pelletike, argjilo-silicore, sericitike, kuarcore, alevrito-ranore si dhe bashkëshoqërimi me rreshpet grafitike, me mineralizimet e hekurit, vanadiumit e me lëndën organike. Të tilla premisa vërehen në zonat e Korabit e Gashit. Fosforitet e moshave të reja eocenike e miocenike bashkëshoqërohen me faciet mergelore, ranorike e argjilore me gllaukonit. Shtresa me gllaukonit njihen në Ultësirën Pranëadriatike dhe në gropat e brendshme. Koefficienti gjeokimik (Serjani A. 1988) i propabilitetit të formimit të v.b. fosfatik rezulton mjaft i lartë sidomos për depozitimet e kretakut dhe eocenit, pra fosfori i ardhur në pellgun detar është përqëndruar në nivele të veçantë stratigrafik duke formuar anomalitë ose grumbullime industriale.

Krahas kërkimit të fosforiteve duhet të kërkohen edhe përqëndrimi të apatitit në shkëmbinj të magmatikë e metamorfikë. Anomali të apatitit me grumbullim të tij deri në 5-6 % tashmë njihen të lidhura me shkëmbinj të bazikë me amfibolit, lamprofiret, monconit sienitet, amfibolit etj.

L I T E R A T U R A

1. Çako J. etj. 1976 — Raport gjeologjik i v.b. Ploçë.
2. Duda S. 1989 — Pasurimi i gëlqerorëve fosfatik të vendit tonë. Disertacion.
3. Gucaj A. etj. 1980 — Raport gjeologjik i v.b. Gusmar.
4. Hoxha V., Aliu I. 1979 — Mbi disa shfaqje të mineralizimit të hekurit në rrethin e Dibrës. Përmb. Stud. Nr. 3.
5. Husi R. 1989 — Projekt gjeologjik për kërkim-vlerësimin e fosforiteve në zonën e Panjës.
6. Laska S. 1981 — Raport gjeologjik i v.b. Galisht.
7. Liko V. 1967 — Raport gjeologjik i v.b. Fushë-Bardhë.

8. *Nika Th.* 1988 — Projekt gjeologjik për v.b. Gusmar.
9. *Serjani A.* 1987 — Fosfatmbajtja e brezave antiklinale të Kurveleshit e Çikës dhe perspektiva e tyre. Disertacion.
10. *Serjani A., Husi R., Papa J., Duda S., Qendro Q., N. Nano* 1988 Studim tematico-përgjithësues për hapjen e perspektivës dhe konkretizimin e një objekti në Kurveleshin Qendror.
11. *Serjani A.* 1988 — Epokat fosforogjenike dhe depozitimet fosformbajtëse të vendit tonë. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 3.
12. *Georges Mechaïres, Ilias Kedikoglou* 1979 — Decouverte importants deposits de phosphorites en Epir (Greece) C. R. Acad. Sc. Paris. t. 288 Seria D.
13. *M. Slansky,* 1980 — Geologie de phosphates sedimentaires. Memoire du B.R.G.N. Nr. 114.

PHOSPHORITES OF THE IONIAN ZONE. THEIR ENRICHMENT AND EXPLOITATION

This paper provides briefly the spreading, lithological-stratigraphical-sedimentological and chemical features of phosphorites of the Ionian zone. The ways of the enrichment and the directions of their further prospection are also given here.

Two following stratigraphical levels with phosphatic mineralization are known in carbonate deposits of the Ionian zone (fig. 1):

a- Jurassic phosphorites linked with the break in sedimentation, situated between the Lower Middle Liassic massive limestones in the basement and the Doger-Malm deposits on the top.

b- Upper Cretaceous (Coniacian) phosphatic horizon. It is the most important one.

Upper Cretaceous phosphatic horizon

It is represented by a geological complex consisting of the intercalations of limestone and phosphatic limestone layers with phosphatic and chert ones. The phosphatic facies is widespread through entire the Ionian tectonic zone in Albania and in Greece (fig. 2, 3). Although vast regional extension, the industrial concentrations are limited. They occur mainly in the Kurveleshi anticlinal belt. Depending to the ratios of the constituents such as limestone, phosphorite and chert change P_2O_5 average contents and metrepercentage (fig. 4). In the central subzone of the Ionian zone (Kurveleshi anticline belt), where are situated the main deposits (Fushëbardhë, Galisht, Nivicë and Gusmar) the horizon has a remarkable phosphatic character. The Gusmari deposit distinguishes for richphosphorite layers.

The rhythmic intercalations of the limestone phosphatic and chert facies are frequent in the horizon 10-15 % P_2O_5 contents predominates in phosphatic layers. The phosphatic layers consist of the massive micritic and biomicritic phosphorite with laminated structure (photo 1). Numerous globotruncanas (photo 2), phosphatic pelets and abundant coprolites (photo 3) occur in phosphatic layers. The phosphatic horizon has been formed under the conditions of an open sea basin. The phosphatic and carbonate muds have been deposited in a reducing environment, without clastio-terrigenous furnishing. The diabase bodies coming out through sedimentary faults have possibly influenced to the formation of an alkaline

environment favourable for the separation of phosphate. The diagenetic processes have played an important role to the phosphatization of microfauna and carbonate. There exist right dependences between P_2O_5 and F, Na_2O and the contrary ones between P_2O_5 and CO_2 and CaO and SiO_2 . Sr, U, REE occur as useful associating elements.

The main perspective of phosphatic horizon is linked with the layers and packs with 10 % P_2O_5 . The perspective of rich-phosphate layers is related with the Fushëbardhë-Panjë-Gusmar-Nivicë central anticlinal chain and with the Ftera eastern anticlinal one.

The technological investigations reveal that the most effective technological way for banded phosphorites (10-15 % P_2O_5) is that of the combination and washing with the melasse solutions. The final concentrate varies from 34 to 43 % and P_2O_5 recuperations reach to 87-93 % (in industrial conditions).

Finally, the authors are of the opinion that, apart from the Ionian zone, the premises for phosphorite exist also in another tectonic zones of Albania, such as Korabi, Gashi, Cukali, Pre-Adriatic depression and inner basins. The prospection of poor apatite mineralizations in magmatic and metamorphic rocks is also recommended.

KARAKTERISTIKA GJEOLGO- PETROGRAFIKE E DISA SHKËMBINJVE DHE MINERALEVE INDUSTRIALE TË VENDIT TONË

Agim Tërshana, I.S.P. të Gjeologjisë
Ismail Turku, Fak. Gjeologji-Miniera

Ë N D E R

Gjatë studimeve dhe kërkimeve gjeologjike, krahas mineraleve metalore janë bërë të dobishëm për ekonominë popullore edhe shumë minerale jo metalore e shkëmbinj që tashmë quhen industriale. Mineralet industriale të njohur deri tani në vendin tonë arrijnë rreth pesëdhjetë. Studimet gjeologjike janë kryer në shkallë jo të njëlojtë për këto minerale. Në disa prej tyre janë përcaktuar rezervat gjeologjike e industriale dhe për objektet kryesore janë kryer edhe studime teknologjike të pasurimit e përpunimit, si për asbestin, fosforitet etj. Ndërkohë disa minerale kanë shkallë të pakët njohje e presin të hulumtohen më thellë, si: dausoniti (Vaso P. 1977), ceolitet (Metalogjenia e Shqipërisë 1989). Minerale të tjera si brusiti, datoliti, opali (Tërshana A. 1984, 1987) janë zbuluar vetëm si shfaqje, por kanë të dhëna gjeologjike për perspektivë të mëtejshme.

KARAKTERISTIKA GJEOLGJIKE

Shkëmbinjtë dhe mineralet industriale kanë përhapje të gjere në vendin tonë. Në pasqyrën 1 jepet klasifikimi gjenetik i tyre.

Ky klasifikim ka karakter gjeologjik e petrografik

Si i tillë ai lehtëson kuptimin e kushteve të ndodhjes dhe të kërkimit të shkëmbinjve dhe mineraleve industriale. Në vendin tonë kanë zhvillim të gjerë formacionet magmatike, sedimentare dhe metamorfike (fig. 1). Formacionet magmatike përhapen gjerësisht në zonën strukturoro-faciale të Mirditës. Ato ndeshen edhe në zonën e Korabit, të Gashit e Cukalit. Tufë hinore takohen edhe në zonën Jonike.

Në Mirditë zhvillohet kryesisht kompleksi ofiolitit. Në zonat e tjera shkëmbinjtë magmatikë paraqesin anësim petrokimik subalkalinor. Në të gjenden granite, albitofire tufë kaliumore, barit fluorit etj. (Turku, I. etj. 1965, 1967, 1969; Bodinaku R. etj. 1968; Tërshana A. 1971, 1972; Marishta S. 1978; Duraç A. etj. 1984). Këtu nuk përmendim gurët natyrorë të

thore. Në Gipsar-Mengaj gips anhidridi shoqërohet me llojin strukturor alabastër, gurë i punueshëm zbukurimi (Ohri S. 1985).

Përfundime dhe rekomandime

1- Klasifikimi gjenetik i dhënë është më i përshtatshmi për mineralet e shkëmbinjtë industrialë të vendit tonë.

2- Rezervat minerale aktuale dhe perspektive që ka nëntoka jonë në mineralet kryesore industriale janë të mëdha.

3- Olivinitet përbëjnë një ndër mineralet kryesore industriale. Ato duhen kërkuar dhe në brezin perëndimor ofiolitik me cilësi e me kushte më të mira shfrytëzimi. Xhami vullkanik ka vend të kërkohe në objekte të rinj dhe në komplekse paraofiolitike. Albitofiri është shkëmb alkalinator kryesor në kompleksin vullkanogjen paraofiolitik. Ai duhet kërkuar dhe në komplekse të ngjashme ofiolitike. Për granitin e Levrushkut gjetja e ngastrave sa më cilësore, me përmbajtje sa më të ulët hekuri, është detyrë aktuale e gjeologjisë, krahas detyrës së pasurimit, Magneziti i Gomsiqes lyp studime më të plota vlerësuese, sidomos teknologjike që të vihet në përdorim sa më parë. Ndërkaq duhen kërkuar objekte me cilësi më të lartë. Kaolina ka përhapje të madhe në ofiolitet perëndimore, mbetet të gjendet në objekte të reja edhe më cilësore, ndërkohë që duhet bërë industrializimi i plotë i saj.

Rërat kuarcore duhet të kërkohe edhe në zona të tjera tektonike, në formacionin sedimentar dhe metamorfogjen. Argjilat të kërkohe në lloje të reja e me fusha të tjera përdorimi, në zonat e brendshme e të jashtme të Albanideve. Dolomitet, që njihen në rezerva të mëdha e cilësore, duhen studiuar më thellë teknologjikisht për përdorim më të gjerë në vend e për eksport. Gjips-anhidriti me rezerva kolosale, lyp studime më të plota nga ana e teknologjisë kimike e të ndërtimit, për futjen në përdorim më të gjerë në vend dhe për eksport.

L I T E R A T U R A

- Bodinaku R., Turku I., Tërshana, A., Konçi Xh. 1968 — Tufet e Dumresë dhe vlera e tyre praktike. Përmb. Stud., nr. 8.
- Duraj A., Duka V., Nikolla M. 1984 — Fluorit në shkëmbinjtë karbonatorë. Bul. Shk. Gjeol., nr. 2.
- I.S.P.G.J. 1989 — Metalogjenia e Shqipërisë.
- Luli F. 1988 — Mbi përdorimin e albitofireve në bujqësi. I.S. Tokave.
- Marishta S. 1978 — Tufet potasjike të rajonit të Gramshit, Përmb. Stud. nr. 1.
- Ohri S. 1985 — Vendburimi i gips alabastrit Gipsar-Mengaj. Bul. Shk. Gjeol., nr. 3.
- Sulejmani R., Tërshana A. 1987 — Mineralizimi i magnezitit në vendburimin e Gomsiqes. Bul. Shk. Gjeol., nr. 3.
- Tërshana A. 1971 — Mbi mineralizimin baritik të malit të Levrushkut. Përmb. Stud., nr. 3.
- Tërshana A., Toçi B. 1972 — Veçoritë gjeologo-petrografike të xhamave vullkanikë të vendburimit të Lumbardhës. Përmb. Stud., nr. 3.

- Tërshana A.* 1980 — Përhapja dhe zhvillimi i kores së tjetërsimit kaolinos të pjesës veriperëndimore të Mirditës. Përmb. Stud., nr. 4.
- Tërshana A., Marishta S.* 1984 — Shfaqje borosilikati në shkëmbinjtë vullkanogjenë dhe ultrabazikë. Bul. Shk. Gjeol., nr. 1.
- Tërshana A., Sulejmani R.* 1987 — Mineralizimi i brusitit në vendburimin e magnetitit Gomsiqe. Bul. Shk. Gjeol., nr. 1.
- Toska Z., Selenica Y.* 1988 — Horizonti i argjilave të bardha (montmorilonitike hidromikore) në zonën e Alpeve, Bul. Shk. Gjeol., nr. 3.
- Turku I., Tërshana A.* 1985 — Albitofiret e Gurit të Zi (Shkodër). Përmb. Stud., nr. 1.
- Turku I., Tërshana A. etj.* 1969 — Granitet e Levrushkut, lëndë e parë feldshpatike. Përmb. Stud., nr. 12.
- Vaso P.* 1977 — Mbi mineralizimin dausonitik të rajonit të Komanit. Përmb. Stud., nr. 2.

GEOLOGICAL-PETROGRAPHICAL FEATURES OF SOME INDUSTRIAL ROCKS AND MINERALS

About 40 industrial minerals and rocks are known in Albania, ^{most} following of which are now included in economic use: olivinite, volcanic glass, granit, talc, kaolines, various, argillas, limestones, dolomites, gypsum, rock salt, marbles, decorative stones etc.

The genetic and geological-petrographical classification is given based on their conditions and way of formation.

In the Geological and Tectonic Maps of PSR of Albania (fig. 1) are given the fields of the spreading of magmatic, sedimentary and metamorphic formations and the main objects of the respective nonmetalliferous mineralizations.

In the magmatic formations of the Mirdita zone is mainly developed the ophiolitic complex. The following industrial rocks and minerals occur in it: olivinite, volcanic glass, magnesite, asbestos, talc etc. The albitophyre, potassium volcanic tuffs, barite, fluorite and other industrial rocks and minerals belonging to the subalcaline rocky complex are developed in magmatic formations of other zones.

In the sedimentary formation of all the tectonic zones occur the following clastic industrial rocks and minerals: quartzeous sands, kaolines of the weathering crust; pelites; the argillas of various mineralogical type; biochemical rocks: carbonates, limestones, dolomites, chalk, phosphatic limestones; chert-silicites, agates, tripolies, diatomites; evaporites: gypsum-anhydrite, rock salt.

In the metamorphic formation of the Korabi and Gashi zones are spread marbles, quartzites, graphitic schists, phyllitoides etc. In the peripheral part of the Mirdita zone, at the contact with the ultrabasics, occur amphibolites and quartz-garnet-micaceous schist, whereas, the serpentinites are common inside and in the periphery of the ultrabasic massifs.

Olivinites — are monomineral rocks with the forsterite olivine with 46-48 % MgO contents. They are spread in the eastern belt of ultrabasics, where the main deposit is Kalimashi. In the tectonite and cumulate sequences of the ultrabasics of the western belt are recommended prospection works. Volcanic glass of the intermediate-acid composition — is spread in the basalt-dacitic volcanic complex of the Central Mirdita, where Qaf Bari is the main deposit.

Albitophyre — is a kind of the volcanic rocks with 8-9 % alkali contents and K₂O varying from 4 to 7 %. For similar subalcaline formations in the Korabi, Gashi

and Mirdita zones are also recommended prospection works to find the objects with higher alcali contents and with better exploitation conditions (fig. 2).

Granit known in the Levrushku deposit, represent a quartz-feldspathic raw material of medium to high quality (alaskite facies) with 2-0,3%, iron contents.

Magnesite — the mineral of the hydrothermal nature, known from the Gomsiqe deposit and several other occurrences, with 40 % MgO and about 6 % SiO₂ contents (fig. 4).

Kaolin — derived from the alteration of leucogabbros. The Korthpula, Dedaj, Vig etc. deposits are known in the western part of the ophiolite gabbro-peridotite formation (fig. 5).

Quartzeous and quartz-feldspathic sands-spread in new Tertiary up to Quaternary deposits in the Devolli, Tirana etc. basins.

Argillas — some sorts as bentonites (Prrenjasi type), porcelaneous (Tamara type), hardly smelted (Alarupi type), illite — hydromicaceous argillas etc. are in exploitation.

Dolomites — they commonly co-associate the Triassic and Jurassic carbonate deposits in the Ionian, Albanian Alps zones etc. Some deposits are known (Dukati etc.). MgO contents ranges from 18 to 21 %.

Gypsum-anhydrite — raw material of colossal reserves founded in the Korabi, Ionian zones etc.

|, | | ?

RAJONIZIMI HIDROGJEOLGJIK I SHQIPËRISË

Romeo Eftimi N. Hidrogjeologjike Tiranë
 Ibrahim Tafilaj, N. Hidrogjeologjike Tiranë
 Guxim Bisha, N. Hidrogjeologjike Tiranë

H Y R J E

Tablloja hidrogjeologjike e Shqipërisë është tepër e koklavitur. Si bazë për rajonizimin hidrogjeologjik kanë shërbyer strukturat gjeologjike. Në pikpamje gjeologjike Shqipëria bën pjesë në brezin rrudhosës Alpin. Në sistemin e Albanideve bëjnë pjesë disa zona tektonike, të cilat i mbihipin njëra tjetrës nga lindja drejtë perëndimit. Dallohen këto zona hidrogjeologjike: zona e Korabit, zona e Mirditës, zona e Alpeve shqipëtare, e Gashit, e Krasta-Cukali dhe zona Kruja-Jonike (fig. 1).

1. Zona e Korabit

Zona e Korabit përfaqëson krahun perëndimor të antiklinalit të madh të Korabit dhe ndërtohet kryesisht nga shkëmbinj paleozoikë të metamorfizuar. Këta shkëmbinj në përgjithësi kanë çarshmëri të imët dhe prurjet e burimeve janë rreth 0,1 l/sek, kurse në konglomeratet takohen burime me prurje deri 10 l/sek, Nga gëlqerorët paleozoikë të Shullanit të Radomirës del burimi i staneve të Prushit me prurje rreth 100-600 l/sek dhe Izviri i Radomirës me prurje 200 1500 l/sek.

Ndërmjet shkëmbinjve metamorfikë zbulohen dy dalje gipsesh e anhidridesh të permo-triasikut prej të cilëve dalin burime sulfatike të ftohtë me prurje deri 200-300 l/sek si dhe burimet termomineralë sulfurorë të Llixhës së Peshkopisë me përbërje $SO_4 - Ca$, me mineralizim të përgjithshëm 3,7 deri 4,4 gr/l, përmbajtje të gazit sulfuror 49 mg/l dhe temperaturë 35 deri 43,3°C.

Depozitimet e shkriфта të paleocenit dhe kuaternarit të përfaqësuara nga konglomerate, ranorë, argjila e zhavore, të cilat mbushin ultësirën e Peshkopisë nuk dallohen për ujëmbajtje të lartë, prurjet e burimeve zakonisht nuk kalojnë 0,2 — 0,3 l/sek dhe shpesh kanë përbërje sulfatike, me mbetje të thatë rreth 1 gr/l.

2- Zona e Mirditës

Këtu takohen dy peligje ndërmalorë, ai i Burrelit në veri dhe i Mokrës në jug, të cilët janë të mbushur me molasa kenozoike. Ndër ofiolitet,




Fig. 6 — Prerje hidrogeologjike tërthore në pjesën veriore të pellgut të Tiranës (Sektori i Rilës).

1- Rëra; 2- subrëra; 3- subargjila; 4- argjila; 5- zhavorre; 6- konglomerate; 7 niveli i ujrave nëntokësore; 8- shpërthe me thellësira në m dhe me presionin e ujrave nëntokësore.

— Transversal hydrogeologic section in the northern part of the Tirana basin (Rila sector).

1. Sands; 2. Subsands; 3. Subargillias; 4. Argillias; 5. Gravels; 6. Conglomerates; 7. Ground water level; 8. Drillings with the depth in m and with the ground water pressure.

të madhe mbetja e thatë arrin deri 7-8 gr/lit dhe përbërja bëhet klorur-sodike.

Ujërat nëntokësore të depozitimeve zhavorrore janë në përgjithësi të freskëta me mbetje të thatë rreth 0,3 deri 0,7 gr/l, në përgjithësi mesatarisht të forta deri në të forta në pjesën jugore dhe qëndrore të pellgut dhe të buta deri shumë të buta në pjesën veriore të tij, (fusha e Rilës) ku ndodh zbutja natyrore e tyre.

L I T E R A T U R A

1. Instituti i Studimeve Gjeologjike (1983) — Harta Gjeologjike të R.PSSH shkallë 1 : 200 000.
2. Ndërmarrja Hidrogeologjike (1985) — Harta Hidrogeologjike e R.P.S. të Shqipërisë, shkallë 1 : 200 000.
3. Bisha G., Prenga Ll. (1980) — Ujërat nëntokësore të zonës së Rilës. Tiranë.
4. Bisha G., Eftimi R. (1981) — Ujrat nëntokësore të zonës Vjosë — Shushicë Vlorë.
5. Eftimi R. (1966) — Vështrim mbi hidrogeologjinë e fushës aluviale të lumit Mat. Përmb. Stud. Nr. 4, Tiranë.
6. Eftimi R. (1975) — Ujrat nëntokësore të fushës së Lushnjës. Përmb. Stud. Nr. 2, Tiranë.
7. Eftimi R., Tafilaj I. (1979) — Një vështrim i shkurtër mbi ujrat nëntokësore të Shqipërisë. Përmb. Stud. Nr. 1, Tiranë.
8. Eftimi R. (1985) — Vetitë filtruese dhe ujëbollshmëria e shtresave ranoro-konglomeratike të serisë Rrogozhina. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 2, Tiranë.
9. Gjata K., Kodra A., Pirdeni A. (1980) — Gjeologjia e disa pjesëve periferike të zonës Mirdita. Përmb. Stud. Nr. 3, Tiranë.

10. Gjata A., Lako A., Eftimi R., Tyli N. (1965) — Kushtet hidrogjeologjike të zonës Koplík-Fushë Krujë — Tiranë.
11. Prenga Ll. (1984) — Hidrogjeologjia e rajonit Lushnjë-Peqin-Rrogozhinë, Tiranë.
12. Shallo M., Vranai A., Gjata Th. (1980) — Përfytyrime të reja mbi Albanidet Lindore. Përmb. Stud. Nr. 2, Tiranë.
13. Shehu R., Lleshi, B., Gjata K., Shallo M. etj. (1980) — Shënime sqaruese mbi hartën tektonike të Shqipërisë. Përmb. Stud. Nr. 4, Tiranë.
14. Shtrepi P. (1972) — Shkalla e mbylljes hidrogjeologjike të disa rajoneve naftëmbajtëse në brezin e Kurveleshit. Nafta dhe Gazi, Nr. 1, Patos.
15. Tafilaj I. (1973) — Klasifikimi hidrogjeologjik i vendburimeve të mineraleve të dobishëm. Përmb. Stud. Nr. 2, Tiranë.
16. Tartari M. (1980) — Ujrat nëntokësore të luginës së Beratit. Tiranë.
17. Tyli N. (1971) — Kushtet e formimit të ujrave nëntokësore në ultësirën e Korçës dhe rëndësia e tyre për shfrytëzim. Përmb. Stud. Nr. 3, Tiranë.

HYDROGEOLOGIC DIVISION OF ALBANIA

1- Geography and climate

Albania has a territory of 28749 km² and his landscape is mainly mountainous, with an average altitude of 714 m above sea level. Albania belongs to the Mediterranean climate belt, but owing to its mountainous landscape the climate varies greatly. Annual mean temperature for the coastal regions varies from 14° to 17°C, while in the mountain regions it is about 10°C. The annual mean precipitation varies from 700-800 mm in the southeastern part up to more than 3000 mm in the Albanian Alps in the north. Albania has abundant surface water, the total annual surface run off is 42.25×10^9 m³, while total annual ground-water flow is 12.8×10^{-9} m³.

2- Hydrogeological division.

Geologically Albania belongs to the folded Alpine belt. In the system of folds that constitute the so-called «Albanides» have been distinguished six hydrogeological regions (fig. 1).

The *Korabi region* consists mainly of the Paleozoic metamorphosed rocks, such as schists as well as minor quartzites, conglomerates, limestones and gypsum. The yields of springs are in the order of 0.1/s in schists, 1-10 l/s in conglomerates and up to more than 100 l/s in the limestones and gypsum.

The groundwater usually is low mineralized of bicarbonate-calcium type, but in gypsum the groundwater is mineralized of sulphide type cold or thermomineral as Llixha spring with 3.7 to 4.4 total concentration, 35 to 43.3°C, 49 mg/l H₂S gas.

The *Mirdita region* consists of the Jurassic ophiolite such as intrusive, volcanogenic and volcano-sedimentary rocks, Triassic and Cretaceous limestones and dolomites. In this region there are also intermountainous depressions of Burreli and Mokra.

The intrusive rocks, mainly ultrabasic and basic are characterized by an increased water-bearing capacity in tectonic zones having a transmissibility varying from 30 to 110 m²/d. The outputs of the wells reach to more than 10 l/s while the flow of the tunnels reach up to 300-400 l/s.

The volcanogenic and volcano-sedimentary rocks are poor or very poor aquifers.

The limestones and dolomites constitute some very abundant karstic basins. There are four springs with a yield of more than 1 m³/s and about 35 springs with a yield from 0,1 to 1 m³/s (fig. 2).

The sandstone-conglomerate molasse deposits of intermountainous depressions of Burreli and Mokra have a different permeability, the yield of wells vary from 0.1 to 10-15 l/s, while the gravelly deposits of Korça plain are more abundant and the maximum yield of the wells is about 100-150 l/s (fig. 3).

Generally, the groundwater quality is very good.

The *Gashi region* consists of the Paleozoic schists, volcano-sedimentary rocks and granodiorites with a generally low permeability, and also of Triassic limestones with a high permeability. Some karstic springs have a yield from 10 to 100 l/s.

The *Albanian Alps region* consists generally of strongly karstified Mesozoic limestones and dolomites, very abundant in groundwater of high quality. There are three springs with a yield ranging from 0.1 to 1 m³/s drained directly in Shkodra Lake. The gravelly Quaternary deposits of Kopliku and Shkodra plains also are very abundant in groundwaters of a good quality, the yield of wells usually vary from 10-20 l/s to more than 130 l/s.

The *Krasta-Cukali region* consists mainly of the Cretaceous-Paleogene flysch and some Cretaceous or Triassic-Cretaceous limestone structures.

While the flysch is characterized as practically impermeable, the limestones are generally karstified, and from them emerge some important springs with a yield more than 0.1 m³/s.

The *Ionian-Kruja region* is characterized by the presence of longitudinal structures with a NW-SE extension. The anticlines consists of the Mesozoic and Paleogene carbonatic rocks, while the synclines are filled with the Paleogene and Neogene flysch and Quaternary gravelly deposits.

Generally, the carbonate rocks are strongly fissured and karstified, forming thus important groundwater reservoirs from where water emerges as strong springs in the deep valleys, or at the limestone flysch tectonic contact (fig. 4). In this region emerges «Syri i Kaltër» spring the biggest Albanian's spring with a mean discharge of about 16-18 m³/s, and also 10 springs yielding from 1 to 10 m³/s and 30 springs yielding from 0.1 to 1 m³/s.

Quaternary gravelly deposits also form important groundwater reservoirs, the yields of wells usually vary from 10-15 up to more than 100 l/s.

In karstic water of this region four chemical types can be distinguished: HCO₃-Ca type in limestones; HCO₃-Mg type in dolomites; SO₄-Ca in karstic water coming in contact with gypsum deposits and Cl-Na type, mainly in coastal and submarine springs. There are also some sulphur thermomineral springs with a temperature from 22.5 to 55°C and with a sulphur gas contents from 4 to more than 400 mg/l.

In the north-western part of the region, there are two artesian basins: *Adriatic and Tirana basin*. These basins in depth consist of the Mesozoic carbonate rocks, overlaid by the Paleogene flysch and Tortonian and Pliocene molasse deposits (fig. 6).

The carbonate rocks contain sulphur thermomineral water with a temperature up to 50-60°C and with a salinity up to 60-70 g/l. The sandstone aquifer of the Tortonian deposits generally have a low permeability, the median specific yield of the wells is about 0.04-0.1 l/s/m. The sandstone-conglomerates of Rrogozhina formation (Pliocene age) occurring only in the Adriatic basin, represents a better aquifer,

the median specific yield of the wells is 0.4 l/s/m and the well outputs range between 1 to 15 l/s. Generally, the water of the Rrogozhina aquifer formation is hard of MCO_3 -Mg type with high contents of iron reaching up to 3-4 mg/l.

The gravelly Quaternary deposits form the most important and highly productive aquifer the transmissibility usually vary from 1000 to about 8000 m^2/d , and specific yields vary from 10 to more than 100 l/s (fig. 7). The quality is generally good.

PËRSOSJA E PËRMIRËSIMI I TEKNOLOGJISË SË SHPIMIT-KUSHT THEMELOR PËR PLOTËSIMIN E DETYRAVE NË KËRKIM-ZBULIMIN E MINERALEVE TË DOBISHME

**Kiço Karabina I.S.P. të Gjeologjisë
Elmaz Leka Ministria Ind. Min. dhe Energjitikës
Xhavit Aliçka Ministria Ind. Min. dhe Energjitikës
Koçi Rate N. Gjeologjike Tiranë.**

H Y R J E

Partia jonë, që në vitet e para pas çlirimit, krahas problemeve të shumta e të vështira, të cilat sh. Enver Hoxha i ka përshkruar me aq largpamësi në librin «Kur u hodhën Themelet e Shqipërisë së re», dha orientimin për ngritjen e shërbimit gjeologjik shqiptar të kësaj dege të rëndësishme për kërkimin, zbulimin dhe vënien në shfrytëzim të pasurive të nëntokës tonë. Ne jemi bashkohës dhe dëshmitarë të kujdesit të vazhdueshëm e të veçantë të Partisë, për zhvillimin dhe fuqizimin e përndërprerë të punimeve gjeologjike në të gjithë gjërësinë e kompleksitetin e tyre. Mjafton të përmendim rritjen e volumeve fizike në shpime, të marrë në 5-vjeçarin e parë 1951-1955 baras me 100%, në të dytin ato u shtuan në 4,4 herë në të tretin 8,5 herë, në të katërtin 12,4 herë, e deri në të tetin 46,8 herë. Nga disa ekspedita dhe ekipe të vogla me një numër të kufizuar sondash të cekta, ku thellësia e puseve për 4-5 minerale ishte 100 — 200 m, sot, zhvillojnë aktivitetin e tyre 14 ndërmarrje gjeologjike, me sonda të fuqishme të afta për shpime deri në 1500 m, me marrje të plota kampioni. Sot punohet në mbi 100 objekte kërkimi e zbulimi për kërkim-zbulimin e 35 lloj mineralësh të ngurta.

* * *

Vetëm për mineralin e kromit, volumi i shpimeve, që nga viti 1960 është rritur në vitin 1980 rreth 4,5 herë, ndërsa në vitin 1990 ai do të arrijë 7,2 herë më shumë, për bakrin, po nga viti 1960, në vitin 1980 janë rritur 7,8 herë e në vitin 1990, parashikohet 8,6 herë. Edhe punonjësit e shpimit bashkë me tërë shërbimin gjeologjik kanë qëndruar në ballë të luftës dhe të përpjekjeve për të realizuar detyrat e shpimit gjithnjë në

më të mira dhe zbatimin e arritjeve më të mira të teknologjisë bashkëkohore në përshtatje me kushtet dhe mundësitë e vendit tonë.

Shoku Ramiz Alia në takimin me novatorët e rrethit të Shkodrës, në shtator 1986, theksoi «Progresin teknologjik ne do ta arrijmë si nëpërmjet sjelljes së objekteve të plota moderne, ashtu edhe duke aplikuar në detaj, duke modifikuar një makinë duke i vënë sondës së vjetër një instrument modern ose një daltë të përfeksionuar. . . . » Kjo porosi e Partisë përbën për ne një program të madh pune, që krahas përpjekjeve për realizimin e detyrave të sotme, të rritim kërkesa për nivel më të lartë teknik e profesional për tu dhënë zgjidhje problemeve që shtron koha në fushën e përsosjes së teknologjisë së shpimeve.

Së gjashti: përhapja dhe përgjithësimi i përvojës së përparuar në mënyrë të organizuar. Kjo nuk është një çështje e thjeshtë teknike dhe organizative, që lidhet me njohjen e rezultateve dhe të shifrave, ta studjojmë në mënyrë të thelluar, duke nxjerrë në pah atë që është thelbësore sepse kjo rrugë nuk kërkon investime materiale, por një angazhim me dije shkencore e kompetencë profesionale.

Punonjësit e shpimit janë të ndërgjegjshëm për detyrat e mëdha, që kanë përpara, plotësimi i të cilave kërkon një mobilizim të gjithanshëm, me synim që volumet fizike të shpimeve, të jenë rezultat i rritjes së rendimentit në teknologjinë ekzistuese.

IMPROVEMENT OF DRILLING TECHNOLOGY — A PRINCIPAL FACTOR TO GROW THE PROSPECTION EFFECTIVENESS

This paper provides the achievements in the improvement of drilling technology and precises the tasks for the future for the inspections of ore deposits.

Presidentja e Shoqatës Gjeologjike të Bullgarisë, prof. dr. Maria Zheljaskova — Panajotova, pasi vlerësoi nivelin e lartë të punimeve të Konferencës Shkencore Kombëtare, me rëndësi jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për Ballkanin e Mesdheun mbajti kumtesën «Mbi Vermikulitet e Bullgarisë».

VERMIKULITE DEPOSITS IN BULGARIA

Maria Zheljaskova-Panajotova
(Sofia University, Sofia, Bulgaria)

«Vermiculites» are comparatively a new mineral stuff. Their utilization started since 1920 and has tendency of constant increase in volume and spectrum. Nowadays it is a stuff of extreme importance for most of the modern branches of technology, construction (especially the fire-proof one), agriculture, etc. The prices of vermiculites and their products grow steadily and parallelly with the above tendencies. According to different sources of information the price of 1 ton of raw vermiculite is about 200 US dollars varying from 140 to 210 dollars in respect to its quality.

«Vermiculite» is a summarized name of iron-magnesium hydromicas (hydrobiotite, hydrophlogopite and their fully hydrated varieties — vermiculites with 22-23% (weighted) of water. They form at surface conditions during weathering of trioctahedral micas from the raw biotite-phlogopite. Only a special (unique) combination of natural mineralization processes leads to vermiculite formation. In nature this happens very rarely — and the industrial vermiculite deposits are also rare. The initial rocks, which later are host ones may be different which influences significantly the composition of vermiculites. At the same time small differences in the structure and chemical composition strongly influence their physical properties. Therefore it follows that the vermiculite stuff is different in quality leading to the need to specify most convenient utilizations. The proved reserves of the western world total 45 mln tonnes, the reserves base is 180 mln tonnes and total world resources are approximately 550 mln. tonnes.

According to the data of Minerals Handbook (1988-1989) and other papers the countries can be arranged in the following way in correspondence with their reserves:

1. USSR, with more than 25 mln. tonnes (Kovdor, Potaninsko deposit, etc.)

The compositional variety (exchange cations and iron content) and the specific structural features of raw vermiculites found in Bulgaria, as well as the already considerable quantities of proved reserves open possibilities for mining and recovering of commercial material which may be used in a wide range of vermiculite-based products for the needs of building industry, metallurgy, chemical technology, fire protection, agriculture and environmental protection (in utilities for pyrrifying industrial water, gases and other wastes). It may be expected that, being the second European country (after the USSR) with economic vermiculite deposits, Bulgaria will be also able to offer vermiculite products to other countries interested in them.

L I T E R A T U R A

1. Barska, S. *God. SU Geol. geogr. Fak.*, 51, Kn. 2, 1958, 133-140.
2. Barska, S. *God. Bullg. Geol. d-vo*, 33, 2, 1972, 153-164.
3. Barska, S. *Sp. Bullg. Geol. d.vo*, 33, 3, 1972, 297-311.
4. Zheljaskova — Panajotova, M. *God. SU, Geol.* — *geogr. Fak.* 53, 2, 1960, 59 — 142.
5. Lvova, I.A. *Tr. VSEGEJ*, t. 126, Izd. Nedra, Leningrad. 1974, 231.
6. Karamata, S. (Ed). *Metallogenetic maps of the ophiolite belts of the North — eastern Mediteranian in 1 : 2 500 000, 1 — western part.* Geoinstitut, Belgrade, 1987.
7. Vakanjac, B. *Tr. 14 kongr. KBGA, Sofie*, 1989.

P Ë R M B L E D H J E

Vermikuliti përfaqëson një lëndë të parë minerale jo metalore relativisht të re, që ka nisur të përdoret qysh nga viti 1920 e dora-dorës sot ka arritur të ketë një fushë të gjërë përdorimi në degët moderne të teknologjisë, ndërtimit, agrikulturës etj. Çmimi i lëndës së parë vermikulite mesatarisht është 200 dollar/toni.

«Vermikuliti» është një emër përgjithësues për hidromikat hekuroro-magneziale (hidrobiotit, hidroflogopit) dhe llojet shumë të hidratuara të tyre, me 22-23% ujë. Formohen në kushte sipërfaqësore gjatë tjetërsimit të mikave biotit-flogopite, vetëm në një kombinim special unik faktorësh, ku influencë zotëruese luajnë përbërja dhe struktura e shkëmbinjve mëmë që tjetërsohen e metasomatizohen.

Vendet më të pasura me vermikulit janë: Bashkimi Sovjetik, Amerika e Veriut, Brazili, Afrika e Jugut, Kina, më pak Japonia, Argjentina, India, Kenia, Egjipti, Australia, Meksika etj.

Në gadishullin Ballkanik mineralizimi i vermikulitit ndodhet në shkëmbinj të ultrabazikë, në Bullgari, Greqi, Jugosllavi. Vendburimet më të mëdha janë në Srednogorie (Bullgari). Aty janë gjetur vendburime me mbi 12 milion ton rezerva lëndë të parë që përmban 27% vermikulit. Shfaqjet e vermikulitit shoqërohen me fragmente të vjetra të komplekseve ofiolitike (shkëmbinj ultrabazikë e bazikë të metamorfizuar), të prekur nga metasomatoza potasike dhe amfibolite, gjithashtu të prekur nga metasomatoza dhe mikëzimi intensiv. Në disa shfaqje metasomatoza potasike e shkëmbinjve mëmë lidhet me proceset e granitizimit, ose me një magmatizëm të ri granitoid. Në fig. 1 — jepen lokalitetet kryesore të ver-

mikulitit në Bullgari. Për nga rezervat e vermikulitit Bullgaria zen vendin e dytë në Europë pas Bashkimit Sovjetik, dhe të pestin ose të gjashtin në botë.

Në Bullgari vendburimet e vermikulitit në përgjithësi janë të ngjashëm nga morfologjia: me pamje çarçafi, të parregullt në pjesën e poshtme, me trashësi të luhatëshme nga pak metra deri disa metra, me damarëzime — shtokverke, me pikëzime të shpërndara, ose në çerdhe — fole. Disa herë vendburimet ndërpriten nga trupa pegmatitesh deri në sipërfaqe-kore. Vendburimet e Greqisë janë analogë me ato të Bullgarisë.

Studimi i procesit të vermikulitizimit, nëpërmjet studimit të përbërjes së shkëmbinjve burimorë, natyrës së mikave parësore, zëvendësimit metasomatik, etj. tregon se vermikuliti i formuar përmban $F < 1.00$, kryesisht rreth $0.2-0.3\%$, indeksi i hekurit total (f total) < 35 , tregues këto mjaft cilësorë e perspektivë. Tjetërsimi i zgjatur i ofioliteve mikore dhe rreshpeve kristalore jep prodhime mikash — me shkallë të ndryshme hidratimi. Veçanërisht shumë të hidratuara (me H_2O $19-22\%$), janë vermikulitet apoultrabazike, ndërmjet të cilave ndeshen dhe vermikulitet apoamfibolite, pjesërisht të hidratuara. Në përgjithësi vermikulizimi i mikës ndodh sipas proceseve që pasojnë: gati oksidimi i plotë i hekurit, nga FeO në Fe_2O_3 , largimi i K nga hidratimi intensiv. Studimet me rrextet X , e analizat termodiferenciale, kanë zbuluar përzierje — shtresëzime të vermikulitit me trajta ndërmjetëse: hidroflogopiti, hidrobiotiti, ku përmbajtja e F është më e ulët, dhe f total ulet deri $17-18$ në antarët e hidratuar të fundit. Duke u bazuar në treguesin e kationo-këmbimit vermikulitet e Bullgarisë, p.sh. të vendburimit të Parapandovcit, përfaqësohen nga tipet magneziale, magnezium-kalciumore, dhe kalciumorë.

Në vendburimin Belja Kamak pesha vëllimore e vermikulitit pas djegies është 290 kg/m^3 — Ky është indeksi më i rëndësishëm komercial i termo vermikulitit.

Në përputhje me klasifikimin formacional të propozuar (5), vendburimet e vermikulitit të Bullgarisë futen në disa grupe e tipe, si në: «vendburimet vermikulit-hidroflogopite të komplekseve dunit-harcburgite»; «Vendburimet hidrobiotite në komplekset gneis amfibolite të granitizuara». Ndërsa kanë rëndësi vetëm mineralogjike: «Mineralizimet vermikulite të varfëra në skarnet magneziale», dhe rëndësi potenciale «Mineralizimet hidrobiotite në komplekset dunit-piroksenit-gabro» dhe «mineralizimet hidrobiotite në gneiset biotite melanokrate dhe në shistet». Bullgaria tashmë ka zbuluar vendburime vermikuliti të disa llojeve, me karakteristika specifike strukturore, që mund të përdoren në një shkallë të gjërë për nevojat e industrisë së ndërtimit, metalurgjisë, teknologjisë kimike, mbrojtjen zjarrfikëse, agrikulturë, mbrojtjen e ambientit, industrinë e pastrimit të ujit, gazeve etj.